

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6039
E mërkurë, 17 qershor 2020
çmimi 0.40 €

Thaçi, Lajçakut: Dialogu duhet të fillojë me vizat dhe të përfundojë me njohje

IFAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRITSHMËRITË NË KOSOVË DHE NË SERBI PËR TAKIMIN NË SHTËPINË E BARDHË

Nxehtë në Washington!



A do të arrihet më 27 qershor në Uashington marrëveshja në mes të Kosovës dhe Serbisë?

Më 27 qershor delegacioni i Kosovës dhe i Serbisë do të takohen në Shtëpinë e Bardhë në Uashington. Pjesëmarrjen për këtë takim e kanë konfirmuar të dyja palët. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një konferencë për media mbajtur të martën, ka theksuar se qëndrimi i ShBA-së

dhe ftesa për 27 qershor, për takim në Shtëpinë e Bardhë, rrit shpresën, optimizmin dhe besimin se ky proces do të ketë sukses. Sipas Thaçit, ky proces është për njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kurse presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se Serbia gjendet para një peri-

udhë jo të lehtë, duke pohuar se temë e takimit nuk do të jetë pranimi i pavarësisë së Kosovës, por ekonomia. Ndërkaq ish-kryeministri dhe lideri i LV-së, Albin Kurti, ka thënë se rifillimi i dialogut po iu përshtatet kërkesave të Serbisë si në kohë ashtu edhe në përmbajtje IFAQE 4-5



SHAQIR H. SHAQIRI KA FOLUR PËR "EPOKËN E RE" PËR NDIHMËN SIMBOLIKE QË IA DHA SHQIPËRISË KUR U GODITË NGA TËRMETI

PENSIONISTI QË NDIHMOI SHQIPËRINË NË KOHËN E TËRMETIT PRET TAKIMIN ME EDI RAMËN IFAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION

FAMILJA JASHARI F. 11

Bedri
ISLAMI



AKTUALE



DY FËMIJË HUMBËN JETËN NË LIQENIN ARTIFICIAL NË MILLOSHEVË F. 2

CAKAJ NË BOSNJË: NJOHJA E KOSOVËS, VENDIM I RËNDËSISHËM PËR BALLKANIN PERËNDIMOR F. 2

RAMA PARALAJMËRON ASHPËRSIM TË MASAVE NË SHQIPËRI F. 3

KURTISHI: QEVERIA HOTI PO I PËRSËRITË GABIMET E QEVERISË KURTI F. 6

EKONOMI

RRJETI I SHITËSVE ME PAKICË: BIZNESET PO RREZIKOHEN NGA VONESAT NË ZBATIMIN E PAKOS EMERGJENTE F. 9

REÇICA ZOTOHET SE DO T'I NDIHMOJË EKONOMITË FAMILJARE TË PUNËTORËVE TË PREKURA NGA PANDEMIA F. 9

SPORT

SOT PËRCAKTOHEN FINALISTËT E KUPËS F. 16

E rëndë, dy fëmijëve humbën jetën në liqenin artificial në Milloshevë

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur sot në fshatin Milloshevë të Obiliqit. Dy fëmijë kanë vdekur, pasi kanë rënë në liqenin artificial ku kishin shkuar për t'u larë. Gazeta "Epoka e re" sjell detaje nga tragjedia në Milloshevë.

Kishin shkuar për t'u larë në liqenin artificial të fshatit. Ishin bashkë tre fëmijë, por argëtimi i tyre u ndërpre në momentin kur u hodhën në ujë. Dy prej tyre vdiqën si pasojë e

zhytjes në këtë liqe.

Një banor i fshatit ka provuar t'u dalë në ndihmë, duke e nxjerrë kështu njërin prej fëmijëve. Derisa tjetrin nuk ia kishte dalë ta nxirrte.

Krejt kjo ngjarje ka ndodhur në orën 15:00 të mesditës së sotme. Pas gati dy orësh kërkim, ekipet e kërkim shpëtimit të FSK'së kanë arritur të nxjerrin trupin e pajetë të fëmijës së dytë.

Zëdhënësi i Policisë së Kosovës, Baki Kelani, deklaroi se rasti po cilësohet si "Hetim i vdekjes".

"Policia ka pranuar informacionin se në një liqe artificial fillimisht tre fëmijë kanë shkuar për t'u larë dhe nga informatat e para dyshohet se dy fëmijë kanë hyrë dhe nuk kanë arritur të dalin. Një banor ka marrë veprime të menjëhershme ka arritur që



njërin ta nxjerrë nga lumi. Është tentuar t'i jepet ndihma e parë, por nga ekipet mjekësore është konstatuar se ka humbur jetën", ka thënë Kelani.

Kelani tha se sipas informatave të deritanishme, fëmijët kanë lidhje familjare.

"Rreth orës 17:10 njësitë për kërkim shpëtimit të FSK'së kanë arritur ta nxjerrin edhe fëmijën e dytë. Kanë bërë të

pamundurën që fëmijët t'i nxjerrin dhe t'i shpëtojnë, por fatkeqësisht dy fëmijë kanë humbur jetën dhe është konstatuar vdekja nga ekipet mjekësore. Informatat e para deri në këto momente janë se bëhet fjalë për fëmijë nga 9 deri në 12 vjeç, sipas këtyre informacioneve fëmijët kanë lidhje familjare", ka deklaruar Kelani.



Cakaj në Bosnjë: Njohja e Kosovës, vendim i rëndësishëm për Ballkanin Perëndimor

PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj, gjatë vizitës së tij zyrtare në Sarajevë, zhvilloi një takim me nënkryetaren e Këshillit të Ministrave dhe Ministren e Punëve të Jashtme të Bosnje dhe Hercegovinës, Bisera Turković. Ai në një shkrim publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se gjatë takimit u theksua se njohja e pavarësisë së Kosovës nga Bosnja dhe Hercegovina do të ishte një vendim jo vetëm historikisht i drejtë, por edhe skajshmërisht i rëndësishëm për zhvillimin e

demokracisë e forcimin e prosperitetit të Ballkanit Perëndimor në përgjithësi. "Biseduam për thellimin e marrëdhënieve dypalëshe, veçanërisht nëpërmjet rritjes së shkëmbimeve tregtare dhe nxitjes së turizmit. Vlerësuam bashkërisht rëndësinë e bashkëpunimit rajonal në fushën e ndërlidhjes, transportit, digjitalizimit dhe domosdoshmërinë e përpjekjeve të shtuara drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Po ashtu, theksuam se njohja e pavarësisë së Republikës së Kosovës nga



Bosnja dhe Hercegovina do të ishte një vendim jo vetëm

historikisht i drejtë, por edhe skajshmërisht i rëndësishëm për zhvillimin e demokracisë e forcimin e prosperitetit të Ballkanit Perëndimor në përgjithësi. Në fund, ndamë pikëpamjen e njëjtë lidhur me bashkëpunimin e mirë në një varg organizatash ndërkombëtare, përfshirë OSBE-në dhe UNESCO-n. Gjithashtu, vlen të përmendet mbështetja e Bosnje dhe Hercegovinës për synimin e Shqipërisë për të marrë një vend jo të përhershëm në Këshillin e Sigurimit 2022-2023", ka bërë me dije ministri Cakaj.

Shqipëria dështon në gjurmimin dhe monitorimin e rasteve me Covid-19

Tiranë, 16 qershor - Shqipëria ka dështuar në monitorimin dhe gjurmimin e rasteve me Covid-19. Këtë e thotë raporti ndërkombëtar "Covid-19 Regional Safety Assessment" i Deep Knowledge Group, një firmë investimesh e themeluar në 2014-në në Hong Kong. Për këtë kategori Shqipëria renditet në vendin e 98 nga 100 vende të analizuar në këtë raport. Shqipëria, sipas efikasitetit së karantinës, renditet në vendin e

69, që do të thotë se edhe karantina nuk arriti të kishte sukses të plotë ndaj Covid-19. Edhe për nga efikasiteti e menaxhimit të situatës nga qeveria sipas renditjes, Shqipëria ka dështuar duke u renditur në vendin e 95 nga 100 vende të shqyrtuara.

Edhe përgatitja e urgjencës e ka lënë Shqipërinë jo mirë duke u renditur për këtë kategori në vend të 85-të, kurse sipas rezistencës rajonale Shqipëria renditet në vendin 75-të. Për



gatishmërinë e kujdesit në vendin e 57. Në total, sipas shëndetësor Shqipëria renditet analizës së gjashtë kategorive, 30

indikatoreve dhe 130 parametrave, Shqipëria është renditur për menaxhimin e situatës Covid-19 në vendin e 88. Pandemia Covid-19 vuri në sprovë shumë vende në botë, madje edhe ato vende me një sistem të fortë shëndetësor. Të gjendur përballë një situatë të re dhe mbarë globale, vende të ndryshme e kanë përballuar ndryshe.

Sipas raportit, vendi më i sigurt është Zvicra, kurse më i rrezikuari Sudani i Jugut.

Përfaqësuesi i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka filluar vizitën në Kosovë

Thaçi, Lajçakut: Dialogu duhet të fillojë me vizat dhe të përfundojë me njohje

Përfaqësuesi i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka filluar vizitën në Kosovë. Ai takimin e parë e ka zhvilluar me presidentin e vendit Hashim Thaçi. Pas takimit të dy kanë mbajtur një konferencë të përbashkët për media. Thaçi ka thënë se pozicioni zyrtar i shtetit të Kosovës në procesin e dialogut është se duhet të fillohet me liberalizimin e vizave dhe duhet të përmbyllet sa më shpejt që është e mundur me një njohje reciproke



PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të martën në takim përfaqësuesin e BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Pas takimit, Thaçi e Lajçaku kanë mbajtur një konferencë për media.

Thaçi ka thënë se pozicioni zyrtar i Kosovës është që në këtë proces të dialogut Kosovë - Serbi duhet të fillohet me liberalizim të vizave e të përmbyllet sa më shpejt me njohje reciproke mes dy shteteve. "Kosova ka një të ardhme dhe alternativë të vetme që të jetë pjesë e familjes evropiane. Diskutuam edhe për angazhimet që do t'i ketë

Lajçaku në çështjen e negociatave mes Kosovës dhe Serbisë. Çdo përpjekje që çon drejt normalizimit të plotë mes Kosovës dhe Serbisë është e mirëseardhur. Unë dua të besoj se do të kemi veprime konkrete dhe dobiprurëse për dy popujt nga ky angazhim. Pozicioni zyrtar i shtetit të Kosovës në këtë proces është se duhet të fillojë me liberalizimin e vizave dhe duhet të përmbyllet sa më shpejt që është e mundur me një njohje reciproke", ka thënë Thaçi në konferencën për media pas takimit.

Thaçi ka thënë se Kosova ka besim të plotë në ShBA. "Përqafojmë vlerat evropiane

dhe jemi evropianë. Do të punojmë që këto vlera të ngadhënjë dhe të jemi të vlerësuar nga BE-ja. BE-ja është vonuar shumë dhe duhet të lëvizë më shpejt. Kosova do të jetë në Shtëpinë e Bardhë. Për ne është me rëndësi jetike që ShBA-ja dhe BE-ja të kenë koordinim", ka thënë Thaçi. Ndërkaq Lajçaku e ka cilësuar të frytshëm takimin që pati me

presidentin e Kosovës, ndërsa ka paralajmëruar edhe takime të tjera me zyrtarë të tjerë të Kosovës. "Ne do ta vazhdojmë komunikimin. Do të vazhdoj t'i takoj përfaqësuesit e tjerë dhe do ta vazhdoj vizitën time edhe në Serbi", ka thënë Lajçak. Ai ka folur edhe për takimin në Shtëpinë e Bardhë më 27 qershor. "Shpresojmë se ky proces të vazhdojë dhe do të

ketë takim së shpejti edhe në Bruksel. Nuk e di, por ajo që di është se Bashkimi Evropian ka punuar afër me ShBA-në dhe gjithçka që është arritur në dialog, është rezultat i një bashkëpunimi shumë të ngushtë në mes të BE-së dhe ShBA-së dhe do të doja të vazhdojë ky komunikim i ngushtë me ShBA-në", ka thënë Lajçak.

Rama paralajmëron ashpërsim të masave në Shqipëri

TIRANË, 16 QERSHOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në një lidhje në rrjetin social "Facebook" ka paralajmëruar ashpërsim të masave nëse situata me Covid-19 nuk do të përmirësohet. Edhe pse mendon se situata mund të vihet përsëri në kontroll, mbyllja nuk do të shmanget nëse situata e përhapjes së Covid-19 vazhdon të rëndohet. "Nëse do të vazhdojmë kështu, do të na duhet të rimbyllemi dhe t'i përballojmë edhe një herë pasojat e plagëve që morëm nga mbyllja e parë, por nuk dua ta zgjas



me këtë, sepse kam bindjen se ende e kemi në dorë ta kontrollojmë situatën", ka thënë kryeministri Rama. Ai ka shtuar se nuk do të lejojë më grumbul-

lime të njerëzve, qoftë dhe për grumbullime politike, duke iu referuar protestave që ndodhën javët e fundit në Tiranë. Rama ka paralajmëruar bizne-

set që t'i respektojnë protokollet e sigurisë shëndetësore për parandalimin e përhapjes së infeksionit, në të kundërtën do të përballen me sanksione deri edhe në heqje të lirisë. "Virusi nuk ka këmbë, por përdor këmbët e budallallëkut njerëzor dhe për budallallëkun nuk ka rrugë tjetër veç tolerancës zero për këdo që e shfaqet dhe për kudo që ai i shfaqet në krah", u shpreh Rama. Ditën e martë Ministria e Shëndetësisë raportoi shifra rekord të rasteve ditore me 82 të infektuar, duke shënuar

ditën e katërt radhazi me raste në rritje. Rritja e madhe e numrit të rasteve të prekura me Covid-19 në Shqipëri vjen në kohën kur në vend janë hequr të gjitha masat e detyrueshme të mbylljes së bizneseve, karantinimit e izolimit të njerëzve. Virusit ka lënë të vdekur 37 persona prej kur u shfaqën rastet e para në Shqipëri në muajin mars. Në Shqipëri 1 672 persona janë infektuar, prej të cilëve 1 064 janë shëruar. Aktualisht, raste aktive me Covid-19 janë 571.

Përrurohet asfaltimi i segmentit të parë të rrugës Deçan - Plavë

DEÇAN, 16 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka marrë pjesë të martën në përrurimin e asfaltimit të segmentit të parë të rrugës Deçan - Plavë. Të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, zëvendëskryeministri Besnik Tahiri, ministri i Infrastrukturrës, Arban Abrashi dhe ish-kryeministri Ramush Haradinaj. Para të pranishmëve të

shumtë, kryeministri Hoti tha se është i nderuar të marrë pjesë në përrurimin e kësaj rruge, projekt ky i rëndësishëm për trojet shqiptare. "Jam vërtet i nderuar që në ditët e para të mandatit e përrurojmë një projekt të rëndësishëm të qeverive të kaluara. Disa ministra me radhë kanë punuar në këtë projekt dhe jam shumë i nderuar që sot një pjesë të kësaj rruge e përfundojmë dhe bashkë me ministrin e

Infrastrukturrës morëm obligimet për të çuar më tutje këtë projekt të rëndësishëm për trojet shqiptare", tha kryeministri Hoti. Duke e quajtur këtë rrugë të një rëndësie strategjike për të gjithë shqiptarët, kryeministri Hoti siguroi kryetarin e Komunës së Deçanit se do të jenë së bashku për të çuar deri në kufi këtë rrugë dhe bashkë me bashkëkombësit tanë matanë kufirit ta lidhin deri në destinimin e saj.



Kryeministrit Hoti në këtë ceremoni, nga kryetari i Komunës

së Deçanit, Bashkim Ramosaj, iu nda dekorata "Rruga e jetës".

PRITSHMËRITË NË KOSOVË DHE NË SERBI PËR TAKIMIN NË SHTËPINË E BARDHË

A DO TË ARRIHET MË 27 QERSHOR NË UASHINGTON MARRËVESHJA NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË?



Më 27 qershor delegacioni i Kosovës dhe i Serbisë do të takohen në Shtëpinë e Bardhë në Uashington. Pjesëmarrjen për këtë takim e kanë konfirmuar të dyja palët. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një konferencë për media të martën ka theksuar se qëndrimi i ShBA-së dhe ftesa për 27 qershor, për takim në Shtëpinë e Bardhë, rrit shpresën, optimizmin dhe besimin se ky proces do të ketë sukses. Sipas Thaçit, ky proces është për njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kurse presidenti serb, Aleksander Vuçiq, ka thënë se Serbia gjendet para në periudhë jo të lehtë, duke pohuar se temë e takimit nuk do të jetë pranimi i pavarësisë së Kosovës, por ekonomia. Ndërkaq ish-kryeministri dhe lideri i LV-së, Albin Kurti, ka thënë se rifillimi i dialogut po iu përshtatet kërkesave të Serbisë si në kohë ashtu edhe në përmbajtje

në Shtëpinë e Bardhë, pasi palët janë pajtuar që t'i heqin pengesat për dialog. Grenelli ka thënë se Serbia është pajtuar që ta pezullojë përkohësisht fushatën e çnjohjeve të pavarësisë së Kosovës dhe se Kosova është pajtuar për t'i pezulluar përpjekjet për t'u anëtarësuar në mekanizma ndërkombëtarë.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se me kënaqësi ka pranuar ftesën e emisarit special të presidentit Donald Trump, Richard Grenell, për dialog në Uashington, derisa ka theksuar se përpara kësaj vizite do të zhvillojë bisedime me opozitën dhe forumin e liderëve politikë të partive parlamentare në Kuvendin e Kosovës. Në këtë kontekst, Hoti ka theksuar se ky proces nuk i përket vetëm një qeverie, por të gjithë qytetarëve të vendit. "Sigurisht ne jemi të nderuar që kemi pranuar këtë ftesë. Do t'i zhvillojmë diskutimet e nevojshme me të gjithë, në përputhje me qasjen që kemi premtuar, në mënyrë që si shtet të dalim unikë në këtë proces të rëndësishëm. Unë do të tentoj të kem komunikim

edhe me opozitën përpara se të shkoj në Uashington edhe me forumin e liderëve politikë të partive parlamentare në Kuvendin e Kosovës, për t'i mbajtur të gjithë të përfshirë sepse ky nuk është proces që i takon vetëm një qeverie, por të gjithë qytetarëve të vendit", ka thënë Hoti.

Për takimin në Shtëpinë e Bardhë ka folur edhe presidenti i Serbisë, Aleksander Vuçiq. Ai ka deklaruar se Serbia gjendet para në periudhë jo të lehtë, por që "do të dijë që të luftojë për interesat shtetërore dhe kombëtare". Vuçiqi e ka thënë këtë duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve në Çaçak lidhur me takimin e përfaqësuesve të Serbisë dhe të Kosovës në Shtëpinë e Bardhë, më 27 qershor, të cilin e ka paralajmëruar i dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell. Vuçiqi ka thënë se temë e takimit nuk do të jetë pranimi i pavarësisë së Kosovës, por ekonomia. Ai ka rikujtuar që në kuadër të bisedimeve me zyrtarët ndërkombëtarë pritet vizita në Serbi, e përfaqësuesit special të Bashkimit Evropian

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka konfirmuar pjesëmarrjen e Kosovës në takimin e 27 qershorit në Shtetet e Bashkuara, ku pritet që të takohen delegacioni i Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësim amerikan. Në një konferencë për media mbajtur të martën, presidenti Thaçi ka thënë se Kosova nuk ka kohë për të humbur dhe se është e përkushtuar që të marrë pjesë në këtë proces të negociimit. Ai, po ashtu, ka

thënë se ky proces ka mbështetjen e plotë të presidentit amerikan Donald Trump. "Qëndrimi i ShBA-së dhe ftesa për 27, për takim në Shtëpinë e Bardhë, rrit shpresën, optimizmin dhe besimin se ky proces do të ketë sukses. E para, pasi ky proces e ka mbështetjen e qartë të ShBA-së, të vet presidentit Trump si dhe këmbëngulësinë dhe vizionin e ambasadorit Grenell", ka deklaruar presidenti Thaçi.

Ai ka theksuar se përkushtimi amerikan është që nga procesi i dialogut të rezultojë njohja reciproke në mes të Kosovës

dhe Serbisë si dhe anëtarësimi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. "Uashingtoni e ka thënë qartë se ky proces dhe kjo është thënë qartë në letrat që i ka dërguar vetë presidenti Trump, që ky proces është për njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka shtuar ai.

Të hënën i emëruari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, përmes rrjetit social "Twitter" ka njoftuar se qeveritë e të dyja vendeve janë pajtuar që të takohen më 27 qershor në ShBA. Sipas Grenellit, takimi do të ndodhë

për dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, Miroslav Lajçak, vizita e vet Vuçiqit në Moskë dhe biseda me presidentin rus Vladimir Putin, si dhe që pas kësaj vizite autoritetet e Serbisë “duhet të merren vesh se cili delegacion shkon në Uashington”. “Pres bisedim të mirë me Lajçakun, si dhe një vizitë të mirë në Rusi. Do të shohim, së pari, nëse shqiptarët do të respektojnë atë që ka thënë Grenelli lidhur me moskandidimin në institucionet ndërkombëtare sepse, mos harroni, që më herët (presidenti i Kosovës, Hashim) Thaçi këtë nuk ka dashur kurrë ta pranojë. Unë e kam bërë këtë ofertë katër vjet dhe për katër vjet kam insistuar për këtë, sepse fushata kundër nesh ka qenë e tmerrshme dhe për katër vjet ata nuk kanë dashur ta pranojnë këtë. Tashmë jemi informuar se ata e kanë pranuar”, ka thënë Vuçiq.

LV-ja, PDK-ja dhe AKR-ja deklarohen për takimin në Uashington

Ish-kryeministri dhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se rifillimi i dialogut po iu përshtatet kërkesave të Serbisë si në kohë, po ashtu edhe në përmbajtje. “Data 27 qershor e takimit është aty sepse vjen pas datës 21 qershor kur mbahen

zgjedhjet në Serbi dhe datës 24 qershor kur Vuçiqi shkon në Moskë për t’u takuar me Putinin. Në anën tjetër, që Serbia të jetë e kënaqur, u sajua një qeveri koti në Kosovë, e cila varet nga secili deputet i Listës Serbe, që hoqi reciprocitetin me Serbinë dhe iu zotua emisarit Grenell që nuk do të kërkojë anëtarësim për Kosovën në organizatat ndërkombëtare. (Kjo e fundit është heqje dorë nga neni 17, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.)”, ka shkruar Kurti.

Ai ka shtuar se, “në fakt, më parë se dialog si proces, ky duket si takim njëditor ku servohen marrëveshjet”. “Qasja e këtyrë asimetrike, që ka për pikënisje pabarazinë e normuar midis Kosovës e Serbisë, sjell veçse marrëveshje të dëmshme, rrjedhimisht të papranueshme e të pazbatueshme. Andaj kjo gjen mbështetje vetëm te politikanë e zyrtarë që nuk përfaqësojnë popullin sikurse Thaçi e Hoti”, ka shkruar ish-kryeministri Albin Kurti.

Ndërkaq zëdhënësi i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Avni Bytyçi, ka thënë se qëndrimi i liderit të PDK-së, Kadri Veseli, sa i përket vazhdimin të dialogut në Shtëpinë e Bardhë, nuk ka ndryshuar. “Aty ku janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të jetë Republika e Kosovës dhe institucionet ta përfaqësojnë

Edita Tahiri: Mungesa e unitetit në dialog mund të na kushtojë shumë

Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka thënë se mungesa e unitetit në procesin e dialogut me Serbinë mund t’i kushtojë Kosovës. Këtë vlerësim Tahiri e ka dhënë duke iu referuar zhvillimeve të fundit në vend dhe relacioneve pozitive-opozitive. “Kryeministri thotë unë e udhëheq dialogun, presidenti thotë unë e nënshkruaj marrëveshjen, ndërsa shumica shqiptare në Parlament është në opozitë dhe nuk duan të marrin pjesë në dialog. Kjo mungesë e unitetit mund të na kushtojë shumë...”, ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në “Facebook”.



vendin në mënyrën më të mirë”, ka shkruar Bytyçi në llogarinë e vet në “Facebook”. Bytyçi ka thënë se duhet të mbrohen interesat e vendit pa i ikur përgjegjësisë dhe bashkëpunimit me Amerikën sikurse veproi ish-qeveria Kurti.

Edhe Aleanca Kosova e Re (AKR) e ka mirëpritur ftesën e të dërguarit presidencial amerikan Richard Grenell për ta rifilluar dialogun midis Kosovës dhe Serbisë si dy shtete të pavarura dhe sovranë në Shtëpinë e Bardhë më 27 qershor 2020 që synon të arrijë njohje reciproke siç

përcaktohet në letrat e presidentit Donald Trump. “AKR-ja mbetet e përkushtuar t’i mbështesë institucionet e Republikës së Kosovës për të arritur një konsensus më të gjerë për një çështje kaq të rëndësishme për vendin siç është dialogu për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë dhe ta sigurojë ulësen e Kosovës në Kombet e Bashkuara, BE dhe NATO. Respektimi i rendit kushtetues të Kosovës dhe i integritetit territorial janë kornizat negociuese të vendit në këtë proces. AKR-ja u bënë thirrje të gjitha palëve ta mbështesin këtë

mundësi historike. Kosova gjithmonë ka fituar më 1999 dhe më 2008 dhe në vazhdim kur ka qëndruar me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, miqtë evropianë dhe u ka besuar atyre”, thuhet në komunikatën e AKR-së.

Sipas AKR-së, Kosova ka qenë gjithmonë një projekt i unitetit euroatlantik. “Në këtë frymë, bashkëpunimi midis ShBA-së dhe BE-së është thelbësor për ta siguruar përfundimin e procesit të dialogut. Edhe vizita e përfaqësuesit special, z. Lajçak, sigurisht se shënon një hap përpara në këtë proces”, thuhet në komunikatën e AKR-së.



Ministri Veliu vizitoi Institutin e Kosovës për Administratë Publike

PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, i shoqëruar nga shefi i kabinetit dhe këshilltari i lartë, Bajram Gecaj, kanë vizituar Institutin e Kosovës për Administratë Publike, ku është pritur nga drejtoresha e përgjithshme e Institutit, Refike Sulçevsi dhe drejtori i administratës, Bujar Thaqi. Qëllimi i kësaj vizite ishte për të parë për së afërmi objektin

e ri të IKAP-it, i cili tashmë është funksional dhe ka kapacitetet e plota për ofrimin e trajnimeve për zyrtarët e administratës publike të Republikës së Kosovës. Në këtë takim është bërë me dije se trajnimet do të fillojnë pas marrjes së dritës së gjelbër nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, pasi që momentalisht trajnimet janë pezulluar për shkak të parandalimit të

përhapjes së Covid-19. Gjatë kësaj vizite ministri Veliu ka theksuar se përfundimi i objektit të ri të IKAP-it është shumë i rëndësishëm dhe është në përputhje me reformën në administratën publike, duke pasur parasysh se është një ndër kriteret për përmbushje të standardeve në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave dhe anëtarësimit në BE.



Kurtishi: Qeveria Hoti po i përsëritë gabimet e qeverisë Kurti

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Anëtari i kryesisë së PDK-së, mjeku Ilir Kurtishi, ka alarmuar se qeveria aktuale e kryeministrit Avdullah Hoti është duke i vazhduar gabimet e ish-qeverisë së Albin Kurtit për menaxhimin e keq të pandemisë Covid-19. Kurtishi ka thënë se që nga fillimi i pandemisë PDK-ja ka dalë me rekomandime konkrete se si të bëhet menaxhimi i saj por, siç ka treguar ai, qeveria Kurti bëri politikë me pandeminë, duke keqpërdorur sëmundjen sa ishte në pushtet e duke abuzuar qytetarët të cilët i ftonë në protesta në mes të pandemisë. "Kulmi i papërgjegjesisë përballë pandemisë u demonstrua me organizimin e një tubimi e koncerti nga Vetëvendosje në sheshin e Prishtinës, ku u përfshinë edhe ish-krerët dhe zyrtarët e lartë të qeverisë, dhjetë ditë pasi u larguan nga pushteti. Sa ishin vetë në qeveri ftonin për kujdes dhe distancë sociale, kur dolën prej saj nuk u mërzitën për shëndetin dhe jetën e qytetarëve. Me keqardhje po vëmë re se edhe qeveria aktuale po përdor të njëjtën qasje që kemi dëgjuar para tre muajve, e që në realitet maskon paaftësinë në luftën kundër Covid-19", ka thënë Kurtishi. Ai ka shtuar se Kosova ka shumë ekspertë të zotë, që

gjatë këtyre tre muajve mund të ishin angazhuar në testim, gjurmim, izolim dhe trajtim të Covid-19. "Dhe sot, kur është bërë hapja parë e ekonomisë, virusi është kthyer në përmasa të mëdha, ndërkohë që nuk kemi parë asnjë plan për ballafaqimin e kësaj situatë. Prandaj, i bëjmë thirrje qeverisë aktuale që të mos i përsërisë gabimet e qeverisë së kaluar, por të angazhohet sa më shpejt dhe me seriozitetin maksimal për ta ndaluar përhapjen e rritjes së koronavirusit. Po ashtu, u bëjmë thirrje qytetarëve, të cilët kanë treguar një durim dhe kujdes shembullor, që të mos ulin kujdesin dhe vëmendjen. Kërkojmë nga të gjithë që t'i respektojnë udhëzimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, që ta ruajnë distancën sociale dhe të kujdesen për njëri-tjetrin", ka thënë ai.

Kurtishi ka theksuar se punonjësit shëndetësorë, të cilët kanë përsipër barrën më të madhe në luftën kundër pandemisë, kanë qenë dhe janë këtu për të gjithë qytetarët. "Falënderojmë secilin prej tyre për punën profesionale të shkëlqyer që kanë bërë dhe po bëjnë. Le të jemi të vëmendshëm dhe le të përpiqemi të gjithë për ta kaluar sa më lehtë dhe më shpejt këtë gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike", ka deklaruar Kurtishi.



Selimi dhe Wigemark flasin për bashkëpunimin MD-EULEX

PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka pritur të martën në takim shefin e EULEX-it, Lars Gunnar Wigemark. Gjatë takimit, ministri Selimi e ka vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm që EULEX-i ka pasur me Ministrinë e Drejtësisë, nga i cili është bërë e mundur që standardet e sistemit të ri të drejtësisë të

jenë në përputhje me standardet dhe kriteret e Bashkimit Evropian. Në këtë takim ministri Selimi, duke folur për prioritetet e tij në krye të Ministrisë së Drejtësisë, ka theksuar se forcimi i sundimit të rendit dhe ligjit si dhe zbatimi i reformave në drejtësi janë objektiva, përgjegjësi dhe më shumë punë për forcimin e sistemit

dhe shtetit të së drejtës, pa harruar edhe sfidat që presin zgjidhje në periudhën aktuale.

Duke vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm, Wigemark konfirmoi edhe një herë mbështetjen e vazhdueshme të misionit EULEX për institucionet e Republikës së Kosovës, veçanërisht Ministrinë e Drejtësisë.



Shaqir H. Shaqiri ka folur për “Epokën e re” për ndihmën simbolike që ia dha Shqipërisë kur u goditë nga tërmeti

Pensionisti që ndihmoi Shqipërinë në kohën e tërmetit pret takim me Edi Ramën



Pensionisti Shaqir H. Shaqiri, i cili para gjashtë muajve pati ndarë 10 euro nga pensioni i vet për ta ndihmuar Shqipërinë pas goditjes nga tërmeti, pati prekur zemrat e gjithë shqiptarëve me gjestin solidar. Ai është nga Medvegja, por që nga viti 1980 jeton në Kosovë. Në një rrëfim për gazetën “Epoka e re” të dhënë dje, ai ka treguar arsyen e veprimit human që u bë motiv për të gjithë. Shaqir H. Shaqiri ka thënë se është në pritje të takimit me kryeministrin Edi Rama, të cilin ia ka premtuar ky i fundit. Shtatëdhjetëvjeçari që ka shkruar disa libra, ka treguar se ka disa dhurata dhe kërkesa për kryeministrin shqiptar. Dëshira e tij është ta ketë shtetësinë shqiptare

tre muaj atje kam qenë refugjat me familje, në rrethin e Korçës. E kam pasur obligim ta ndihmoj Shqipërinë. Për Shqipërinë jam në gjendje të bëj çdo gjë”, ka thënë Shaqiri, i cili, teksa flet për të, s’i pushon lotët.

Veprimi human i Shaqirit kishte prekur edhe kryeministrin shqiptar Edi Rama i cili kishte shpërndarë videon e tij duke e quajtur hero. Rama kishte premtuar se do ta takojë nga afër të moshuarin që u bë motivim për të gjithë.

Gjashtë muaj më pas, pensionisti që dikur ishte mësues pret takim me kryeministrin shqiptar. Ai shpreson se Rama do ta mbajë premtimin për këtë takim.

Por, nëse Rama nuk do të vijë ta takojë, Shaqiri ka thënë se gjatë kësaj vere do të shkojë vetë në Tiranë dhe do të bëjë përpjekje ta takojë kryeministrin Rama. “E kam dëgjuar kryeministrin Edi Rama që ka thënë se do të më takojë. Unë e pres këtë takim. Se kur do të ndodhë nuk e di. Por, nëse nuk më takon ai, këtë verë, nëse jam shëndosh e mirë, unë do të shkoj në Shqipëri dhe do ta takoj atë. E kam botuar një libër për të të cilin do t’ia jap”, është shprehur ai.

Shtatëdhjetëvjeçari ka treguar se ka disa dhurata dhe kërkesa për kryeministrin shqiptar. “Përveç librit, kryeministrin shqiptar do t’ia dhuroj edhe dy shalle, njërin me flamur të Kosovës e tjetrin me flamur të Shqipërisë. Gjithashtu, do t’ia jap edhe dy

gurë, njëri i mermerit të Banjës së Sjarinës dhe tjetri i Trepçës. Nga Edi Rama do të kërkoj të m’i japë 200 lekë nga kuletat e tij, jo e shtetit. Vetëm kjo kartëmonedhë e lekut të Shqipërisë më mungon. Do ta kërkojë ta kem edhe pasaportën shqiptare”, ka treguar ai.

Nga dashuria që ka për Shqipërinë, ai ka treguar se shumicës së liderëve politikë të këtij vendi i ka kushtuar poezi. “Unë e kam dashur edhe Sali Berishën, të cilit ia kam kushtuar një poezi. E kam dashur Enver Hoxhën. Ne e kemi dashur Shqipërinë dhe kemi vuajtur për të. Natyrisht se e dua edhe Edi Ramën, të cilit ia kam kushtuar një poezi”, ka deklaruar Shaqiri.

Nuk bën të jepet Trepça për Luginën e Preshevës

Shaqir H. Shaqiri, i cili nuk guxon ta vizitojë vendlindjen e tij, në rrëfimin për gazetën “Epoka e re” ka thënë se Kosova nuk duhet të pranojë ta japë Trepçën për një pjesë të Luginës së Preshevës. “Pak besoj se Lugina e Preshevës mund t’i bashkohet Kosovës. Unë shtëpinë dhe pasurinë i kam në Banjë të Sjarinës, por unë nuk dua që Kosova ta marrë atë pjesë dhe ta humbë Trepçën, sepse Trepça është pasuri e madhe për Kosovën dhe nuk duhet ta japë kurrë”, ka thënë ai, duke treguar problemet me të cilat përballen shqiptarët e asaj pjese. Sipas tij, ajo pjesë e shqiptarëve vuan shumë nga pushteti serb, i cili

vazhdimisht ia ka shkelur të drejtat elementare. “Situata e shqiptarëve në Luginë është e vështirë. Ndoshta Presheva e Bujanoci janë më mirë, ndërsa në Medvegjë jemi shumë keq. Kanë mbetur shumë pak shqiptarë aty. Unë më nuk guxoj të shkoj në Medvegjë sepse jam i përndjekur nga pushteti serb atje”, ka thënë ai.

Shaqiri e ka ftuar Qeverinë e Shqipërisë dhe të Kosovës që t’i ndihmojnë sa më shumë shqiptarët e Kosovës. “Dy qeveritë shqiptare do të duhet t’i ndihmojnë shumë shqiptarët. E di se i kanë dhënë disa ndihma, por do të duhej edhe më shumë në mënyrë që shqiptarët të mos shpërngulen nga atje”, ka thënë Shaqiri.

Me tej, ai ka treguar për kohën që ka jetuar në Medvegjë dhe më pas në Kosovë. “Mua më kanë rritur Kosova dhe Shqipëria sepse unë jam i Medvegjës. Kam punuar 20 vjet në arsim në Banjë të Sjarinës, pastaj 21 vjet në Obiliq. Tash jam pensionist dhe merrem me shkrime”, ka deklaruar ai.

Shaqiri ka thënë se ka dëgjuar që dikush nga diaspora po mbledh ndihma për të. Ai i ka ftuar ata që mos ta bëjnë një gjë të tillë sepse nuk ka nevojë. “Kam dëgjuar që mërgata ka nisur të mbledhë para për mua, por unë dua t’u them atyre se nuk jam i dobët. Fatmirësisht, qëndroj mirë në aspektin e mirëqenies. Kam banesë dhe pension”, ka deklaruar Shaqir H. Shaqiri.

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Shaqir H. Shaqiri quhet i moshuari që para disa muajve ndau 10 euro nga pensioni i vet për ta ndihmuar Shqipërinë e cila ishte goditur nga tërmeti. Ai është nga Medvegja, por që nga viti 1980 jeton dhe krijon në Prishtinë.

Ndonëse në pamje të parë duket si një pensionist i zakonshëm, ai nuk është i tillë. Shaqir H. Shaqiri ka shkruar disa libra dhe botuar dhjetëra poezi. Ai njihet edhe me pseudonimin “Kalaja”.

Njeriu, veprimi i të cilit preku të gjithë shqiptarët, në një rrëfim për “Epokën e re” ka treguar arsyet e këtij gjesti solidariteti. “Unë jam pensionist dhe jam i sëmure nga sheqeri. Kur tërmeti

goditi Shqipërinë ndjeva dhimbje të madhe. Populli i Kosovës filloi të grumbullojë ndihma. Atë ditë kisha marrë pensionin dhe ndjeva obligim ta ndihmoj Shqipërinë me 10 euro. Zemra më kushtonte të jap më shumë, por ato para i kisha, sepse paratë e tjera të pensionit i kish harxhuar për barna dhe gjëra tjetër personale”, ka thënë ai.

Sikurse në videon që bëri xhiro në rrjete sociale në mbarë hapësirat shqiptare, edhe në këtë rrëfim emocionohet disa herë ka shprehur dashurinë për Shqipërinë. “Ato para që kisha i dhashë sepse Shqipërinë e dua shumë. Kur flas për Shqipërinë emocionohem shumë. Madje e kam shkruar një ditar për Shqipërinë sepse gjatë luftës për

Rrjeti i Shitësve me Pakicë: Bizneset po rrezikohen nga vonesat në zbatimin e pakos emergjente

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Procedurat e tejzgatura dhe vonesat në disbursimin e mjeteve nga Pakoja Emergjente Fiskale për biznese po rrezikojnë stabilitetin financiar dhe pamundësojnë rimëkëmbjen e kompanive të prekura nga Covid-19 thuhet në reagimin e Rrjetit të Shitësve me Pakicë.

Rrjeti i Shitësve me Pakicë ka shprehur shqetësim lidhur me zbatimin e ngadalshëm të masave nga Pakoja Emergjente Fiskale që ndërlidhen me mbulimin e pagave të punonjësve dhe qirave për objekte. "Rrjeti cilëson se këto ndihma të parapara përmes kësaj pakoje janë esenciale për të punësuarit dhe bizneset andaj, vonesat në disbursimin e mjeteve po kanë efekte negative

dhe po e bëjnë situatën të pamenaxhueshme. Mbështetja ndaj punonjësve në sektorët ku është ndërprerë aktiviteti si rezultat i masave kufizuese të ndërmarra, shtesat ndaj kolegëve në pika të shitjes të cilat janë ekspozuar ndaj virusit në baza ditore dhe mbulimi i një pjese të qirave si lehtësim për biznese, janë të domosdoshme për garantimin e mirëqenies së qytetarëve dhe mbarëvajtjen ekonomike", thuhet në reagimin për media.

Sipas tyre, vonesat për disbursimin e këtyre mjeteve po minimizojnë efektin e pakos në ekonomi dhe po rrisin mosbesueshmërinë në institucione dhe pakënaqësinë e punonjësve. Në këtë mënyrë, Rrjeti i Shitësve me Pakicë, duke ripërsëritur nevojën e veprimit të shpejtë, kërkon që institucionet përgjegjëse t'i shtojnë veprimet për zbatimin e



plotë të Pakos Emergjente Fiskale në mënyrë që të mbështeten bizneset të cilat janë prekur nga Covid-19 dhe punonjësit e tyre si dhe t'i hapet rrugë rimëkëmbjes ekonomike.

Reçica zotohet se do t'i ndihmojë ekonomitë familjare të punëtorëve të prekura nga pandemia

PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica të martën ka pritur në takim përfaqësuesit e BSPK-së, Avni Hajdini dhe Ymer Ymeri, me të cilët ka diskutuar lidhur me gjendjen ekonomike të krijuar në përgjithësi në Kosovë gjatë kohës së pandemisë, në veçanti rreth dikasterëve të cilët janë më të atakuar. Në këtë takim, ministri Reçica dhe përfaqësuesit e BSPK-së janë

marrë vesh për fuqizimin e dialogut social nëpërmjet Këshillit Ekonomik Social, me qëllim të avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve në përgjithësi. Në fund të takimit, ministri Reçica dhe përfaqësuesit e BSPK-së janë zotuar se do të bëjnë gjithçka që është e mundur për ta ndihmuar ekonominë e vendit, njëkohësisht edhe ekonomitë familjare të punëtorëve për tejkalimin e kësaj situatë.



Sindikatat i drejtohen Hotit për Ligjin e Pagave dhe tërheqjen e kursimeve nga Trusti

PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - SBASHK-u, Sindikata e Shëndetësisë, e Policisë, e Doganave, e Zjarrfikësve, si dhe Sindikata e Pavarur e Administratës së Kosovës, i janë drejtuar me një kërkesë kryeministrit Avdullah Hoti me rastin e rishikimit të buxhetit për vitin 2020.

Në njoftimin për media këto sindikata kanë thënë se Kushtetuesja, pas dy pezullimeve, pritet që të sjellë vendim meritore sa i përket Ligjit të pagave dhe me këtë të nisë implementimi i tij dhe që të punësuarit të marrin paga në bazë të koeficienteve të

parapare me këtë Ligj. "SBASHK-u, FSSHK-ja, SPK-ja, Sindikata e Doganës së Kosovës, ajo e Zjarrfikësve dhe SPAK, po ashtu ,kërkojnë nga kryeministri Hoti që të zhvillojë konsulta me sindikatat lidhur me idenë e ngritur e që ka të bëjë me Trustin Pensional. Çështjen e tërheqjes së vlerës prej 10 përqindësh nga shuma e akumuluar e të punësuarve në Trust këto sindikata janë duke e debatuar me të punësuarit në këta sektorë dhe në takim me kryeministrin do ta prezantojnë mendimin e anëtarësisë", thuhet në njoftimin e këtyre sindikatave.



Ambasadori i Shqipërisë dhe ai i Italisë shprehin gatishmëri për bashkëpunim në fushën e ekonomisë

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Vesel Krasniqi, ka takuar të martën ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, dhe ambasadorin e Republikës së Italisë në Kosovë, Nicola Orlando, me të cilët ka diskutuar për thellimin e bashkëpunimit ekonomik të Kosovës me Shqipërinë dhe Italinë



ministrin Krasniqi për detyrën e re, duke i ofruar bashkëpunim dhe shprehur gatishmërinë e Republikës së Shqipërisë për ta

përkrahur integrimin dhe zhvillimin ekonomik e politik të Republikës së Kosovës. Po në takimin e tyre u diskutua edhe rritja e qarkullimit të mallrave dhe prodhimeve në mes të Kosovës dhe Shqipërisë dhe lehtësirat që duhet të vazhdojnë që të rriten shkëmbimet tregtare.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka pritur të martën në takim edhe ambasadorin e Republikës së Italisë në Kosovë, Nicola Orlando, me të cilin kanë diskutuar për thellimin e bashkëpunimit ekonomik dhe për vazhdimin e mbështetjes së Italisë për Kosovën. Krasniqi e ka falënderuar ambasadorin Orlando për ndihmën e Italisë ndaj Kosovës që nga përfundimi i luftës, duke veçuar mbështetjen për ndërtimin e

institucioneve të Republikës së Kosovës.

Ministri Krasniqi e ka njoftuar ambasadorin për projektet e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe për Ligjin për Investime Strategjike që krijon shumë lehtësira për investitorët potencialë që do të investojnë në Kosovë. Po në takim u diskutua edhe mundësia e rritjes së shkëmbimeve tregtare Kosovë - Itali, sidomos në produktet bujqësore. Ndërsa ambasadori Orlando ka deklaruar se pret nga qeveria të punojë shumë në rritjen e transparencës, forcimin e ligjit dhe luftimin e korrupsionit. Ai, po ashtu, ka theksuar se Italia do ta vazhdojë mbështetjen për Kosovën, duke konfirmuar interesimin për shkëmbime tregtare dhe investime në mes të Kosovës dhe Italisë.

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Vesel Krasniqi, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, me të cilin ka biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit dhe zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara në mes të Prishtinës dhe Tiranës. Ministri Krasniqi ka falënderuar ambasadorin Minxhozi për

vizitën dhe bashkëpunimin, duke vlerësuar ndihmën e shtetit shqiptar për Republikën e Kosovës.

Krasniqi dhe ambasadori Minxhozi kanë diskutuar edhe për sezonin turistik dhe për masat që duhet të respektohen për t'u mbrojtur nga pandemia, duke u pajtuar që të kenë takime vazhdueshme që t'i eliminojnë të gjitha barrierat që mund të paraqiten në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.

Ndërsa ambasadori e uroi



Ministria e Bujqësisë merr vendime për përshpejtimin e pagesave të granteve

PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), pas lehtësimit të masave mbi menaxhimin e Covid-19, përmes dy vendimeve të reja të cilat hyjnë në fuqi më 22 qershor, inkurajon fermerët dhe agro-përpunuesit që ta vazhdojnë punën e tyre të pandalshme për zbatimin e projekteve të granteve. "Në këtë drejtim janë shfuqizuar dy vendime pezulluese, me qëllim që përfituesit e granteve t'i përfitojnë pagesat e tyre sa më parë. Vendimi i datës 16 mars 2020 për pezullimin e përkohshëm të afateve për zbatimin e projekteve përfituese të granteve të vitit 2019. Me shfuqizimin e

vendimit në fjalë obligohen të gjithë fermerët përfitues të projekteve të Programit të Zhvillimit Rural 2019 t'u përmbahen afateve procedurale të përcaktuara sipas udhëzimit administrativ për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillim rural për 2019, të datës 21.05.2019", thuhet në njoftimin e MBPZHR-së. Sipas këtij njoftimi, vendimi i dytë ndërlidhet me shtyrjen e afateve procedurale për marrjen e lejeve dhe licencave, lidhur me fushën e hortikulturës, produkteve për mbrojtjen e bimëve, plehrave, mbrojtjes së bimëve, farërave, blegtorisë, pylltarisë, verëtarisë dhe shërbimeve këshilluese për bujqësi.



Malisheva shënoi Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve

Malishevë, 16 qershor (ER) - Komuna e Malishevës, me disa aktivitete të kufizuara, të martën ka shënuar 16 Qershorin - Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve, pasi kjo datë lidhet me rënien e dëshmorit të parë dhe dëshmorit të fundit dhe me Ditën e Çlirimit të Malishevës. Aktivitetet festive të këtij viti janë të kufizuara për shkak të pandemisë.

Për shënimin e 16 Qershorit, Kuvendi i Komunës së Malishevës e ka mbajtur një mbledhje solemne si dhe janë ndarë çmimet tradicionale, për trimëri dhe heroizëm, për kontribut në shkollën shqipe dhe për kontribut në shëndetësi. Më pas janë bërë nderime pranë shtatores së komandantit legjendar Adem Jashari, homazhe në Varrezat e Dëshmorëve në Malishevë dhe

në Kleçkë si dhe nderime pranë lapidarit të dëshmorit të parë Imer Krasniqi.

Në mbledhjen solemne të mbajtur me rastin e shënimit të 16 Qershorit, fjalë rasti kanë mbajtur kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kryesuesi i KK të Malishevës, Rrahim Morina dhe kryetari i Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, në Malishevë, Metush Kryeziu.

Kryetar i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka folur për vlerat historike dhe rrugëtimin e Malishevës deri në çlirimin përfundimtar të saj. "Malisheva ka pasur një histori të veçantë prej komunave të tjera, pasi disa herë është formuar dhe është shpërbërë komuna, ndërsa përpjekjet për liri nuk janë ndalur asnjëherë, për t'u kurorëzuar me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,



për t'u çliruar përfundimisht nga okupimi qindrvjeçar. Meritë për këtë ditë kanë të gjithë dëshmorët e kombit, martirët, veteranët e luftës dhe e tërë popullata e Malishevës", ka thënë Begaj.

Metush Kryeziu, në emër të

organizatave të dala nga lufta, ka thënë se sot është dita më e veçantë për Malishevën, Dita e Çlirimit, e dëshmorit të parë dhe dëshmorit të fundit. "Ne si kategori të dala nga lufta jemi të nëpërkëmbura dhe situata e veteranëve është e pakë-

naqshme", ka thënë ai, duke kërkuar më shumë kujdes për organizatat e dala nga lufta. "Një komb që nuk ka dëshmorë është i mjerë, por më i mjerë është ai komb që ka dëshmorë dhe nuk i respekton ata", është shprehur Kryeziu.

Më pas, është zhvilluar edhe ceremonia e ndarjes së çmimeve, ku me vendim të Kuvendit të Komunës, me çmimin për trimëri dhe heroizëm "Imer Krasniqi", janë nderuar Ismet Kafexholli dhe Avdi Gashi, kurse me çmimin për kontribut në shkollën shqipe "Hamdi Berisha" janë nderuar mësuesja Fatmire Bogiqi (pas vdekjes) dhe Xhemajli Bytyçi, ndërsa për kontribut në shëndetësi "Dr. Shpëtim Robaj", janë nderuar mjeku Mexhid Toplana dhe infermieri i pensionuar Hajrë Mazreku.

Komuna e Skenderajt dhe USAID-i nënshkruajnë marrëveshje për mbështetjen e të rinjve

SKENDERAJ, 16 QERSHOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Skenderajt, Nuredin Lushtaku, së bashku me drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Abdyl Ymeri, kanë pritur në takim drejtorin e Programit "Up to Youth", Daniel Cruz, me të cilin kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për zbatimin e Programit për Ngritjen e të Rinjve në Skenderaj.

Në kuadër të këtij projekti do të realizohet një projekt pesëvjeçar i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), i cili ka për qëllim përfshirjen e rinisë, duke i mobilizuar dhe angazhuar ata për të bërë ndryshime të caktuara.

Pjesë e këtij programi do të jenë të rinjtë e moshave 15-24-vjeçare, të cilët do të ndahen në



dy grupe të moshave 15-18 dhe 18-24-vjeçare, duke zhvilluar aktivitete të caktuara për këto moshë.

Nën kryetari i komunës, Nuredin Lushtaku, u shpreh i kënaqur me bashkëpunimin që ka pasur komuna deri me tani me organizatën USAID, duke treguar gatishmëri edhe për përkrahje të mëtejshme nga komuna për realizimin e këtyre projekteve.

Funksionalizohen laboratorët e fizikës, kimisë dhe biologjisë në dy shkolla të Drenasit

Drenas, 16 qershor (ER) - Komuna e Drenasit, nën asistencën e nënkryetarit të komunës, Nazmi Hasi, asistentit të tij të fizikës, PHD kandidat Arber Zeqiraj dhe drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit, Muhamet Gjoka, kanë funksionalizuar dy laboratorë të fizikës, kimisë dhe biologjisë, donacion nga Banka Botërore, në ShFMU "Xhevë Lladroci" në Gallanasellë dhe në ShFMU "Dëshmorët e Qëndresës II" në Tërstenik.

Funksionalizimi i laboratorëve në institucionet arsimore është në vazhden e përmbyshjes së premtimeve të kryetarit të komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, për pragmatizmin e procesit edukativo-arsimor nga lëndët e shkencave ekzakte, të



cilat kanë ndikim themelor në zhvillimin e përgjithshëm teknologjik.

Ky aktivitet i funksionalizimit të laboratorëve të shkencave

ekzakte do të vazhdojë në ditë në vijim edhe në shkollat e tjera përfutuese të granteve të Bankës Botërore dhe investimeve të Komunës së Drenasit.



Qendra e Pestë e Mjekësisë Familjare në Prishtinë bëhet me tunel dezinfektues

PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se Qendra e Pestë e Mjekësisë Familjare në kryeqytet është bërë me tunel dezinfektues. Ai në një postim në llogarinë e vet në "Facebook"

ka shkruar se janë të përkushtuar që së bashku me qytetarët ta kalojnë pandeminë me koronavirus. Ahmeti u ka bërë sërish thirrje qytetarëve që ta vazhdojnë respektimin e masave kundër përhapjes Covid-19.

Lavdia u takon atyre që flijohen për vizione të mëdha (8)

FAMILJA JASHARI



Bedri ISLAMI

Ashtu si është e pamundur ta ndash Shaban Jasharin nga djemtë e tij, po aq e, ndoshta më shumë, është e pamundur t'i ndash nipërit e mbesat nga trangu i tyre. Ata do të rriten të gjithë përmes tij dhe gjyshes së tyre, do ta marrin njëkohësisht ndjenjën e bukur të familjes, por edhe pjesë nga mendimi i saj. Themelore do të jetë që në gjenet e tyre, natyrshëm, krejt njëtrajtshëm, pa asnjë lloj sforcimi, do të rridhte i njëjti gjak dhe e njëjta ide, e cila, megjithëse ende e paformësuar krejtësisht, do të kishte të njëjtat tipare si ato të gjyshërve e katërgjyshërve të tyre.

Do të jenë brezi i gjashtë apo i shtatë i Jasharëve që jetojnë në atë truall. Kjo nuk është e rëndësishme. Ata do të bënin çmos që të ruanin të njëjtin emër të mirë, të njëjtën ndjenjë mirëpritje dhe bujarie, fjalën e duhur në çastin e duhur, mosngutjen dhe respektin; do të kishin në vete, si një amanet të lashtë, që të qëndronin së bashku, deri në mundësinë e fundit, dhe mbi të gjitha, të dinin të vendosnin rendin e gjërave. Dhe rendi i gjërave tek Jasharët fillonte gjithnjë në lidhjen e tyre me tokën e Kosovës, ngastrat e saj dhe vargmalet që i shtrihen nga njëri skaj në tjetrin, rrafshnaltat, ujërat që rrjedhin, të rënë të u flijuan, amaneti i tyre. Nipërit dhe mbesat u mësuan të dëgjojnë fjalë të ndershme dhe të urta, u rritën përmes tyre dhe, njëkohësisht, përmes shembullit që e kishin para vetes, herë tek gjyshi i tyre, pastaj tek gjyshja, tek mixha dhe tek etërit e tyre, tek nënat dhe tek moshatarët. Ishte një rreth i mbyllur, qarkuar gjithandej me ndjenjën e së mirës dhe të afërsisë për Kosovën, dhe jashtë këtij rrethi, ata nuk mund të dilnin dhe as që donin të dilnin.

Edhe sot, në pjesën veriore të shtëpisë së Jasharëve ka një vrimë të madhe me diametër më se dy metra, e cila është shkaktuar nga granatimet. Kjo ndodhi me 7 mars 1998, në ditën e tretë të luftës. Kushtrimi, djali 13 vjeçar i Adem Jasharit, kishte pak kohë që nuk i dëgjonte më krismat e pushkëve nga kullat e shtëpive, e ndoshta ka menduar se është më i fundit në këtë valë qëndrese. Është 13-vjeçar, më duhet ta ripërsëris, që kushdo të mund të ketë në parafytyrimin e tij një djalë të kësaj moshe. Çfarë bën ai? Ai merr përsëri automatikun në orë, me të ka luftuar që në çastin e parë, është dita e tretë e luftimeve, dhe përmes asaj vrime, del në pjesën

tjetër, në mes të dy shtëpive. Nuk e bën në mend të ndalë luftën, qëllon prej aty deri sa i skuqet arma, aty edhe vritet. Është i fundit që bie, ka qenë i pari që e ka ndezë luftën.

Nëse për dikë tjetër, që ishte jashtë, do të dukej e habitshme, se si është e mundur të luftohet një ditë, pastaj një natë, pastaj edhe një ditë tjetër, përsëri një natë e rishtas një ditë, edhe nga fëmijët 13 apo 14-vjeçar, tek Jasharët kjo ishte krejt e natyrshme, e zakonshme, diçka që kishte lidhje me jetën, me emrin e mirë dhe me dëshirën për të bërë diçka më shumë nga sa ishte e mundur.

Në shtëpi ata dëgjojnë të flasin për gjyshërit që kurrë nuk e humbën emrin e mirë, kanë vënë si Zot mbi kokë gjyshin e tyre, e adhurojnë edhe nga fakti se nuk është përlulur, edhe kur ka qenë keq për bukën e gojës, për një kokërr misër, edhe kur e kanë burgosur apo e kanë pushuar nga puna, edhe kur e kanë lëçitur apo nuk i kanë bërë vend, si armik i pushtetit serb, as në një gëzim familjar, e përsëri nuk është dhënë, sepse e ka ditur se është në rrugën e së drejtës, se është në vazhden e ruajtjes së emrit të mirë dhe të dhënies së shembullit të duhur. Jasharët e vjetër ishin mësues të mirë, Jasharët e rinj ishin nxënës të denjë.

Shaban Jashari besonte në pjellorinë e mendjes së tij të çeliktë; besonte se çdo gjë është e drejtë dhe e ligjshme kur është në shërbim të së vërtetës, kjo gjë e bënte atë të zotëronte veten, të kishte të drejtën për të qenë shembulli që duhej ndjekur. Ai ishte në vetëdijen e nipërve e mbesave një ndërgjegje e pastër, por e butë. Dukej hijerëndë, por ishte i dëlirët, nipërve përpiquej t'u jepte dëlirësinë.

Leçitja e pushtetit, burgosja, keqtrajtimet, rrethimet e kullave, kishin dashur që ta bënin të dilte nga populli; por ai kishte hyrë në popull. Ky ishte njëri ndër mësimet që ai u jepte nipërve e mbesave, ua jepte me fjalën e urtë, qetësisht,

la kishin ndaluar të jetë i lirë, por nuk ia kishin arritur, këtë ia përcillte fisit të tij. Ai urrente gënjeshtëtrinë, dhe i thërriste me britma të mëdha së ardhmes, e parandiente, e pikaste që më parë; e parashikonte atë të frikshme, por edhe madhështore, të frikshme sepse kishin përballë një kuçedër, dhe madhështore, sepse çlirimi prej saj do të ishte i përrjetshëm.

Ai e kishte kuptuar që moti se për zgjidhjen e mjerimit të vajtueshëm njerëzor, jo sall të familjes dhe fisit të tij, duhej një çlirues dhe i mëkonte nipërit e mbesat të ishin krah të këtij çliruesi.

Shaban Jashari do të ishte kurdoherë pjesë e përtëritjes së madhe njerëzore, por me logjikë, domethënë, për një shpirt të brumit të tij, në mënyrë të papërkulshme. Logjika ka zemërbutësinë, ai e donte atë në

jetën e përditshme, por edhe donte që njerëzit e tij të kishin zemrën e fortë për kohën që do të vinte. Ai nuk ishte asi njeriu që kishte frikë nga ajo që do të sillte e ardhmja, ai kërkonte vetëm që njerëzit e tij të ishin të përgatitur për të, sido që të vinte, edhe e dhimbshme deri në palcë. Ai nuk kishte droje se vigani popull mund të zgjohej; ai donte vetëm që zgjimi të ishte me logjikë, në kohën e duhur dhe me njerëzit e duhur. Këtë ua mësoi brezave që u rritën përmes duarve të tij dhe prehrat të gjyshes.

Ndoshta më herët se të tjerët ai e kishte parë lirinë të agonte, nuk kishte frikë nga agimi i saj dhe flijimi që do të duhej në emër të lirisë; ky besim i plotë i kishte



dhënë jetë, dhe megjithëse pothuaj i shtyrë në moshë, kur erdhi koha e duhur dhe njerëzit e duhur (ai ishte i lumtur që bijtë e tij ishin aty) kishte filluar të ndjente se si po rriteshin më shpejt se sa duheshin nipërit e mbesat e tij. Ndoshta do të kishte dashur që rrita e tyre të ishte e natyrshme, mirëpo koha vetë ishte tjetër lloj. Nga viti në vit i kishte parë ngjarjet të rriteshin, kishte pasur droje në krye se mos gjithçka dështonte, si kishte ndodhur shumë herë, e vërente rriten e luftës më shumë se sa vërente rriten e njerëzve të tij, e dinte se lufta kishte arsye dhe të drejtën, dhe sa më shumë që ajo, lufta, u fuste frikën pushtuesve serbë, aq më shumë ai e ndjente veten të siguruar. Në 22 janar të vitit 1998, kur pas rrethimit të dytë të Jasharëve, ai shikoi se si trupat serbe po terratisheshin në agoni, mendoi me vete dhe pastaj u tha të tjerëve se "nuk kishte dashur gjë tjetër në këtë jetë, veç të shihte kurrizin e trupave serbe kah ia mbathshin".

Viti 1998 është një vit i ngjeshur. Stuhia është aty, gati, në të gjithë tërbimin dhe madhështinë e saj. Ai është i qetë tashmë. E di se e ka kryer një pjesë të madhe të detyrës së tij; e di krejt mirë si nipërit e mbesat e tij, ashtu si bijtë e bijat, rejtat dhe dashamirët, tashmë janë gati për ta përballuar atë.

Disa qenie njerëzore janë krijuar për furtuna të mëdha. Shpirtrat e mbrujtura për stuhi ekzistojnë në këtë botë. Jasharët janë një shembull prej tyre.

Këta ishin Jasharët deri në 7 marsin e vitit 1998.

Por miti, e aq më tepër miti kombëtar, kërkon besim, ndaj dhe nuk është aspak e udhës që t'i paraqesësh këto njerëz përmes logjikës së kristaltë. Nuk është vetëm ndjenja, ndjenja vëllazërore ajo që mund t'kuptojë. Është shumë më tepër se kaq.

Megjithatë, për të ardhur deri këtu, ka qenë një rrugëzëzim i gjatë...

Si e thashë në fillimin e këtij punimi, për të ditur gjithçka që kishte ngjarë, do të ishte mirë të ktheheshim pak më pas. Pasi u kthym në atë që kishte ndodhur ngjat, le të kthehemi në fillimin e ngulitjes së Jasharëve...

FILLESA

Treqind vjet më parë, nga tre

vëllezër, Jashari, Kadriu dhe Meha në Prekazin e Poshtëm, bri Skenderajt, ngrihen tri lagjet e para të saj; e katërta, më e vonë, do të jetë ajo Lushtakëve. Jashari i madh do të kishte tre djem, më i vogli prej tyre do të jetë Murati, nga i cili rrjedh Fisi i sotëm i Jasharëve. Dy herë, vetëm dy herë, në treqind vite, që nga fillesa dhe deri në marsin e vitit 1998, Fisi i Jasharëve do të kishte nga tre djem. Në fillim, kur nis historia e Fisit dhe në gjakun e Shaban Jasharit. Gjithëherë kishte pasur një djalë të vetëm, fill peri që mund të këputej, rrjedhë që mund të ndalohej, drejtpeshim që mund të prishej. Prandaj edhe është e lehtë të dihen rrjedhat nga kanë ardhur. U është dashur të mbajnë mend vetëm një paraardhës. Asnjë degëzim tjetër. Stërkatragjyshi, katragjyshi, stërstërgjyshi, stërgjyshi, gjyshi, baba... gjashtë breza... më përtej nuk dihej, ajo që do të vinte do të ndërtohej nga vetë njerëzit. Rifati do të ishte vëllai i madh, Hamza pas tij dhe, më i riu, Ademi. Pesë motrat e tyre do të jenë shkak i miqësive fisnike. Ishte bërë hapja e Fisit, si duket ajo që po vinte do të kishte nevojë për më shumë se një krah të Fisit të Jasharëve. Jasharët e tjerë, bri tyre ishin shumuar prej kohe, ata ishin aty, rreth e rrotull, ujë i të njëjtit burim, gjak i përbashkët, do të kishte edhe vazhdimin e prishëm, qëndresë e përbashkët. Ditët e 5, 6 dhe 7 marsit dëshmuar shumë më tepër se gjak të përbashkët.

Të rrosh siç duhet për Jasharët do të thotë të jesh i lidhur me tokën, me livadhet dhe pyjet përreth, të

jesh një vatër e ndershme, bujare, do të thotë të provosh gjithçka, edhe të mirën, edhe të keqen dhe që të dyja në shfaqjen e tyre më të thekshme. Do të ishte e kotë për çdo lloj regjimi që të ndryshonte tiparet e kësaj familje dhe të shpërfytyronte përmasat e Fisit të Jasharëve. Ndodhte diçka e çuditshme, sa herë që presioni shtohet dhe rëndimi i tij dukej i përbindshëm, pa asnjë rrugë shprese dhe mundësie, Familja mbledhesh edhe më tepër rreth vetvetes, tiparet e saj nguliteshin edhe më shumë, deri sa të dukeshin se ishin ngurtësuar. Do të kishte çaste të rënda, do të vinin edhe momente kur dukej se ishte e vështirë të vendosej, dhe do të ndodhte që shumëkujt do i dukej e tepërt, jo vetëm rëndesa mbi këtë Familja, por edhe qëndresa e saj. Ndaj, si kujton Rifat Jashari: "Në ato kohë të vështira, shumë njerëz i kanë thënë babagyshit që ta shesë tokën dhe pasurinë dhe ta lëshojë vendin, sepse kishin menduar se vetëm ashtu familja jonë mund t'i shpëtojë zullumit të madh që po i bënte pushteti. Por, babagyshi nuk kishte dashur ta bënte këtë. Nga të parët, ai kishte trashëguar afër 19 hektarë tokë e mal, dhe këtë pasuri ne, pasardhësit e tij, e kemi edhe sot e kësaj dite, në këtë vend, në Prekaz". Kur thashë më sipër se, nga dhuna, në shenjë qëndrese, tiparet e Familjes dukej sikur ishin ngurtësuar, nuk e kisha fjalën vetëm për burrat e djemtë e kësaj familje. Stërgjyshja e kësaj familje, Halimja, nga fshati Kastriot, atëherë kur njerëzit ngulnin këmbë që Familja të ikte prej vatrës ku kishte bërë jetën e saj, ajo do të ngulte këmbë se "Pasuria nuk shitet. Në qoftë se ky djalë, Shabani, që na e ka falë Zoti, është me ymër, do ta trashëgojë këtë vend".

Si vjen dita, si rrotullohen motet, shkojnë vitet e dekadat, dhe në këtë Familje të duket se nuk ka lëvizur asgjë nga ajo që kanë lënë të parët, është po ajo këmbëngulje, e njëjta forcë, mentalitetin e njëjtë, që lidhet mbi të gjitha me tokën e vendin ku kanë lindur, me arat e bashtinat, me njerëzit dhe pyjet, kullotat dhe ujërat që rrjedhin, me vendin ku e kanë bërë në mend të vdesin. Dekada më vonë, si të ishte pjesë e rikthesës së kohës, Hamzë Jashari, kur do i thoshin se po afrohet ora e dhunës së madhe dhe do të ishte mirë të iknin, diku në perëndim, qoftë edhe sa të qetësoheshin dallgët, do të përgjigjej njëllor si stërgjyshi tij se "Në këtë vend kemi lerë, prej këtij vendi nuk e kemi ndër mend të ikim, këtu edhe do të vdesim". Të duket sikur koha është sjellë rrotull për njëqind, dyqind apo treqind vite dhe ata që kanë shkuar, kanë të lënë të njëjtët në vatrën e tyre. Është rikthim i mrekullueshëm, riciklimi i vlerave dhe i virtyteve. Në të vërtetë kjo do të ishte edhe ndër çastet fatlume të Kosovës.

(Vijon)

BE-ja, thirrje për hetim të menjëhershëm lidhur me varret masive në Libi

TRIPOLI, 16 QERSHOR - Bashkimi Evropian ka reaguar se një hetim i pavarur duhet të fillohet menjëherë në lidhje me varret masive në qytetin Tarhuna në Libi. Në një deklaratë nga Zyra e Përfaqësuesit të Lartë për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë Josep Borrell, thuhet se gjetja e varreve masive ka shkaktuar

shqetësim të madh. "Një hetim i pavarur mbi varret masive duhet të ndërmerret urgjentisht dhe ata që janë përgjegjës duhet të dalin para drejtësisë", theksohet në deklaratë. Borrell u ka bërë thirrje palëve në konfliktin në Libi që t'i respektojnë detyrimet e tyre sipas ligjit ndërkombëtar dhe t'i japin fund dhunës, duke theksuar

nevojën për kthim në procesin politik të udhëhequr nga Kombet e Bashkuara (OKB).

Ushtria libiane, e cila çliroi qytetin Tarhuna në juglindje të Tripolit nga policia e komandantit renegat Khalifa Haftar më 5 qershor, gjeti 106 trupa në një spital të qytetit, kurse më 12 qershor zbuloi tri varre masive në periferi të qytetit.



Trumpi do të nënshkruajë urdhër ekzekutiv për reformat policore



WASHINGTON, 16 QERSHOR - Presidenti amerikan Donald Trump planifikon të nënshkruajë një urdhër ekzekutiv për rritjen e fondeve, me qëllim të ofrimit të trajnimeve më të mira për zyrtarët policorë sa i përket përdorimit të forcës. Aty përfshihet edhe krijimi i një databaze federale për ta gjurmuar sjelljen e keqe të këtyre zyrtarëve.

Ky urdhër, që do të nënshkruhet më 16 qershor, vjen teksa në një numër qytetesh dhe shtetesh

kanë nisur të aplikohen masa të reja si përgjigje ndaj protestave masive të nxitura nga vdekja e afrikano-amerikanit George Floyd.

Floyd ka vdekur pas presionit që i është bërë në qafë me gju nga një zyrtar policor derisa ai ka qenë në mbajtje. Megjithatë, vendimi pritet të mos përmbushë pritjet e pjesëtarëve të Lëvizjes, Jeta e Njerëzve me Ngjyrë ka Vlerë dhe aktivistëve të tjerë, të cilët kanë kërkuar ndryshime rrënjësore të sistemit

të drejtësisë penale. "Qëllimi kryesor është që në dëshirojmë ligj dhe rregull dhe duam që kjo gjë të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të sigurt", ka thënë Trump.

Urdhri ekzekutiv i presidentit vjen teksa Kongresi çon përpara një projektligj më të detajuar rreth reformave policore në nivel federal, ani pse Dhoma e Përfaqësuesve, e kontrolluar nga demokratët, është duke punuar në një projekt të veçantë nga ai i Senatit, të kontrolluar nga republikanët.

Pas 24 ditësh pa infektim, Zelanda e Re regjistron dy raste me Covid-19

WELLINGTON, 16 QERSHOR - Zelanda e Re ka njoftuar të martën se ka regjistruar dy raste të reja me Covid-19 që janë qytetarë që së fundmi kanë udhëtuar në Mbretërinë e Bashkuar. Këto janë dy rastet e para me Covid-19, pasi për 24 ditë resht Zelanda e Re nuk kishte regjistruar asnjë infektim me këtë virus.

Zelanda e Re ka hequr të gjitha kufizimet sociale dhe ekonomike javën e kaluar, përveç kontrolleve në kufi, pasi që kishte deklaruar

se nuk ka raste aktive me Covid-19, duke u bërë kështu njëra ndër vendet e para në botë që iu rikthye normalitetit pas masave kufizuese.

Kryeministria e Zelandës së Re, Jacinda Ardern, ka paralajmëruar se numri i rasteve të reja mund të rritet në të ardhmen teksa qytetarët e këtij shteti po kthehen nga jashtë vendit. Dy rastet e reja janë dy gra të moshave rreth të 30-tave dhe 40-tave, që kishin vizituar prindërit e tyre në

Uellington, njoftuan autoritetet shëndetësore. Dy gratë kishin arritur nga Britania në Zelandën e Re më 7 qershor. Ato kishin pasur leje të posaçme që t'i vizitonin prindërit e tyre, të cilët kanë qenë të sëmurë. Që të dyja janë izoluar tashmë, thanë autoritetet.

Me dy rastet e reja, numri i përgjithshëm i të infektuarve me koronavirus në Zelandën e Re arrin në 1 506, teksa 22 pacientë kanë vdekur.



OBSh-ja paralajmëron rikthim të Covid-19

NYU JORK, 16 QERSHOR - Udhëheqësi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), Tedros Adhanom Ghebreyesus, ka thënë se shtetet "duhet të jenë të përgatitura për mundësinë e rikthimit" të Covid-19 teksa Evropa vazhdon të rihapet dhe Kina përballet me shpërthim të ri, që ka nxitur mbylljen e disa pjesëve të Pekinit.

Teksa numri i rasteve të konfirmuara me Covid-19 arrin në 8 milionë dhe numri i të

vdekurve në 436 000, Ghebreyesus ka theksuar se janë dashur dy muaj për të regjistruar 100 000 raste të prekura me këtë virus, që tani përbën shifër ditore të infektimit dhe se virusi është duke u përhapur me shpejtësi në Azi dhe territorin amerikan.

Paralajmërimet për marrje të masave, me qëllim të luftimit të këtij virusi, kanë



ardhur pasi Kina ka rritur numrin e testeve dhe ka

izoluar disa pjesë të kryeqytetit të saj, me qëllim të kontrollimit të shpërthimit të ri, pas shqetësimeve se kjo mund të jetë vala e dytë e sëmundjes, Covid-19, që shkakton ky virus.

Në gjithë Pekinin, 29 ndërtesa janë vënë nën "menaxhim të mbyllur", pasi të gjitha pikat e hyrjes janë duke u kontrolluar dhe janë vendosur rregulla të

ashpra në lëvizje. Prej 12 qershorit janë regjistruar 106 raste të reja të të infektuarve në Pekin, të cilat duket se kanë marrë virusin në një treg të ushqimit.

Shifrat e reja në Kinë tregojnë se sa i vështirë është procesi i ndaljes së këtij virusi, për të cilin fillimisht është raportuar në Kinë, në fund të vitit të kaluar, mirëpo që atje kishte arritur të kontrollohej pas zbatimit të masave për izolim të ashpër.

Po shtohet numri i refugjatëve drejt Evropës

BRUKSEL, 16 QERSHOR - Në prill është zvogëluar shumë numri i përpjekjeve për kalimin e kufijve të BE-së si pasojë e

Covid-19. Por kjo po ndryshon tani. Si pasojë e Covid-19 në Bashkimin Evropian në prill ra dukshëm

numri i refugjatëve. Në maj janë shënuar rreth 4 300 kalime ilegale të kufirit të BE-së, që do të thotë rreth trefish

më shumë se një muaj më parë, njofton grupi mediatik Funke, duke iu referuar burimeve të Frontexit.



Sylvia Plath, poetja tronditëse e shekullit XX



Nga: Gladiola JORBUS

Sylvia Plath ishte një poete, noveliste dhe shkrimtare amerikane. Ajo ka lëvruar zhanrin e poezisë rrëfyese dhe është e mirënjohur për vëllimet e botuara, ‘*Kolosi dhe Poemat e tjera dhe Ariel*’ si dhe ‘*Kavanozi i ziles*’, një roman gjysmëautobiografik i botuar pak para vdekjes së saj. Më 1982, ajo fitoi çmimin ‘Pulitzer’ pas vdekjes për ‘*Poemat e Mbledhura*’.

Lindur në vitin 1932 në Boston, Masaçusets, Plath studioi në Kolegjin Smith dhe në Newnham College në Kembrixh, Angli. Ajo u martua me poetin anglez Ted Hughes, me të cilin fillimisht jetuan në Shtetet e Bashkuara, e më pas në Angli. Sollën në jetë dy fëmijë, para se të ndaheshin nga njëri – tjetri.

Sylvia Plath ishte një nga poetet më dinamike dhe të admiruara të shekullit XX. Vepra e saj tërhoqi vëmendjen e një numri të madh lexuesish, të cilët konstatuan në vargun e saj njëjës, një përpjekje për të përshkruar dëshpërimin, emocionin e dhunshëm dhe obsesionin me vdekjen.

Në revistën e librit në *New York Times*, Joyce Carol Oates e përshkroi Plath-in si “një nga poetet më të famshme dhe më të diskutuara të pasluftës që shkruajnë në anglisht.”

Intensivisht autobiografike, poemat e Plath-it hulumtojnë ankthin e saj mendor, martesën e saj të trazuar me poetin Ted Hughes, konfliktet e saj të pazgjidhura me prindërit dhe vizionin e saj për veten.

Sylvia shkroi për natyrën, ose për kufizimet shoqërore të individëve, duke e zhveshur poezinë e saj nga penelatat zbutëse. Përkundrazi, përmes procesit të shkruarit, ajo shprehu frikën parësore, kontradiktat, tensionin. Poezitë e Sylvia Plath i nënshtrohen imagjinatës së egër, të lënduar, hedhin imazhe dhe fraza me energjinë e një kali të arratisur.

Në veprën e Plath-it vërejmë përdorimin e paqartë të teorisë psikoanalitike dhe kjo na fton të rivlerësojmë lidhjet e vendosura nga kritikët midis poezisë rrëfyese dhe psikanalizës. Përcjellja e vetvetes, kufijtë e kujdesit të të folurit dalin në pah në poezitë e saj, të cilat lexohen në formë sipërfaqësore, madje duket se ilustrojnë teorinë e Frojdit.

Sylvia Plath nuk e përdor psikanalizën thjesht për të hetuar thellësinë e pavetëdijes së saj. Prania e këtij ligjërimi dëshmon interesin e saj të përjetshëm për të strukturuar veten.

Referencat e shumta ndaj miteve, përrallave dhe folklorit në poezi të mbështetura fort në teorinë psikoanalitike, sugjerojnë se kjo e fundit nuk është, veçse një nga shumë format narrative mbi të cilat Plath-i modelon imazhin e psikikës së saj.

Kjo mënyrë i siguron asaj një mori personazhesh dhe embrionesh narrative të cilat ajo i përdor si pikënisje, duke i lakuar konceptet frojdiane sipas qëllimeve të veta. Psikoanaliza është kthyer në kokën e saj pasi tallja-hermeneutike (metoda e interpretimit të tekstit) e Plath-it vë në lëvizje metaforën dhe identifikimet shtrembëruese të cilat nuk i japin qasje tjetrit, por e kthejnë atë në një krijim letrar. Plath pyet veten nëse përpjekja e saj për përsosmëri vallë a do të sjellë ndonjëherë fryte dhe a do të shfaqet së jashtmi:

‘Kurrë, kurrë nuk do ta arrij përsosmërinë që dëshiroj me gjithë shpirt – pikturat e mia, poemat, historitë e mia – të gjitha

pasqyrime të dobëta ... Shkrimi është dashuria e parë e jetës sime. Unë kurrë nuk mund të jem një shkrimtare e ngushtë dhe introverte, ashtu si janë shumë të tjerë, sepse shkrimi im varet aq shumë nga jeta ime.

Plath-i ka vuajtur nga depresioni gjatë pjesës më të madhe të jetës së saj dhe i është nënshtruar terapisë elektrokonvulsive (ECT). Fundi i saj që tragjik. U vetëvra. Ajo që e shtyu Sylvia Plath (vajzën e profesorit emigrant gjerman Otto Plath) drejt vdekjes ishte e dhimbshme, por e qartë për psikiatrin e saj: depresion klinik.

Nga ana tjetër, pasi poetja e mrekullueshme, kreu vetëvrasje më 11 shkurt të vitit 1963, miqtë, adhuruesit dhe biografët e saj ishin të etur për të fajësuar dikë për këtë tragjedi, një zuzar prej mishi dhe gjaku. Më potenciali ishte bashkëshorti i saj poeti Ted Hughes, i cili e kishte braktisur Sylvian dhe dy fëmijët e tyre të vegjël për të dashurën e tij Assia Esther Wevill. Përkthyesja gjermane, u kish shpëtuar nazistëve në fillim të Luftës së Dytë Botërore dhe kishte emigruar fillimisht në Palestinë, e më vonë në Mbretërinë e Bashkuar. Ajo përjetoi një lidhje 6-vjeçare

me poetin Ted Hughes, por vrau veten dhe vajzën e tyre katër vjeçe Shura duke përdorur një furrë me gaz, vdekje e ngjashme me vetëvrasjen e gruas së parë të Hughes, Sylvia Plath.

Fakti që dhe Assia kreu vetëvrasje pas gjashtë vitesh në të njëjtën mënyrë si gruaja e tij, Sylvia duke lënë hapur gazin e sobës, vulosi fajësinë e Hughes. Në një letër drejtuar mikut të tij të ngushtë Lucas Myers, T. Hughes reflekton nga ana e tij për vdekjen e dy grave që deshi. Në letër rrëfen se për vdekjen e gruas së tij, Sylvia Plath, shkaktare ishte “vendosmëria e tij e sëmurë”, ndërsa në rastin e së dashurës shkaktare ishte “pavendosmëria e tij e sëmurë”. Martesa midis Plath dhe Hughes u shtri në vitet (1956 – 1963). Ajo konsiderohet si një nga martesat më të shqyrtuara e detajuara, në historinë e letërsisë së shkruar në anglisht.

Gjithsesi, poetja amerikane Sylvia Plath (jetës së të cilës i është kushtuar filmi ‘Sylvia’ një prodhim i vitit 2003, interpretuar nga ylli hollivudian Gwyneth Paltrow), edhe pse jetëshkurtër, ka lënë gjurmën e saj të pashlyeshme në botën e letrave. /Mapo/

E rrallë

Aeroporti grek që u la “të kalbej”

Autoritetet greke po shpresojnë se me lehtësimin e masave vendi i tyre do të vizitohet nga shumë turistë, sidomos një aeroport që për 20 vjet rresht është i qetë. Ky aeroport është i vendosur në bregdetin jugor të Athinës. Ish-kompleksi i aeroportit u ndërtua fillimisht në fund të viteve 1930 në një kohë kur aviacioni grek



ishite ende në një fazë zhvillimi. Gjatë pushtimit të Luftës së Dytë Botërore të Greqisë, ky aeroport u përdor nga Luftwaffe e Gjermanisë naziste dhe u bë një shënjestër e sulmeve ajrore aleate. Por vitet e neglizhimit pasuan dhe ky aeroport u la “të kalbet” në mes të mosmarrëveshjeve për rizhvillimin e tij, pas krizës financiare të 2008-s.

BARSOLETA E DITËS



Gruaja, e nervozuar, kthehet në shtëpi.
- Zemër, do ta padis taksistin. Sot, në dy raste, për pak sa nuk më mbyti me veturë.
- Mos u ngut zemër. Po i japim edhe një rast.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

FOTO E DITES



Një qytetar në Londër në këtë mënyrë ka zgjedhur të mbrohet nga Covid-19. /AFP/

Barbra Streisand i dhuron aksionet e “Disney” vajzës së George Floyd

Pasi Kanye West caktoi një fond që do të mbulojë të gjitha shpenzimet e studimit, Gianna Floyd, vajza e George Floyd, mori një dhuratë speciale nga Barbra Streisand, që e kthen tashmë në një aksionere të “Disney”. Në një foto të publikuar në Instagram, vajza 6-vjeçare falënderon legjendën e Hollywood

për dhuratën e saj bujare dhe dy albumet që i kishte dërguar. “Faleminderit @barbrastreisand për paketën e dhuruar, tashmë jam aksionere e Disney falë teje”, shkruan vogëlushja në rrjetet sociale. Nuk dihet saktësisht se sa aksione Streisand i ka dhuruar Gianna-s, por të dhënat zyrtare flasin se 1 prej tyre aktualisht vlen në bursë 115 dollarë.



E jashtëzakonshme

Skulptura të fshehura në një xhungël të Meksikës

Duke ecur në mes të strukturave të betonit në pyllin e “La Huasteca”, ekziston ndjenja që kemi hyrë në një pikturë - një botë me objekte të mrekullueshme që largon mendjen nga problemet e përditshme. Sipas mediave të huaja, karakteristikat e këtyre ndërtimeve zbukurojnë xhunglën edhe më shumë. E njohur edhe si Las Pozas, një lidhje e objekteve, skulpturave dhe shtigjeve të ndërthurura nga përrën timer natyrorë dhe ujëvara, ajo



shtrihet në më shumë se 20 hektarë xhungël tropikale. Ndërkaq ndërtimi i tyre u zhvillua midis viteve 1949 dhe 1984.

 <p>DASHI Nëse me partnerin është krijuar pak tension, mos e vononi çështjen për ta sqaruar. Për ta kthyer harmoninë do të jetë më e thjeshtë sesa mendoni.</p>	 <p>DEMI Do të promovoni një projekt të punës, tek i cili keni shumë pritshmëri. Gjasat janë që të dalë me sukses. Kjo do të thotë se nuk duhet të shqetësoheni për këtë situatë.</p>	 <p>BINJAKËT Dita do të jetë disi e vështirë, me shumë keqkuptime, ankesa dhe mendime jo shumë optimiste. Në dashuri do të jeni pak jashtë ritmit.</p>	 <p>GAFORRJA Rrugua e gabuar dhe vonesat mund të bëjnë që të dështojë një plan. Por, mos u dekurajoni, pasi keni mundësi të gjeni zgjidhje më të mira.</p>	 <p>LUANI Nëse ndiheni të kushëtuar nga kërkesat dhe gjykimet e një familjari, vëri vetes objektivat që të lironi për të marrë vendime.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Perfeksionizmi ju gëlon në vena, por do të ishte më mirë të liroheshit nga kjo, pasi ju streson dhe çon në ndikime negative në raportet profesionale.</p>
 <p>PESHORJA Jeni të hapur për bashkëpunime dhe të gatshëm të jepni ide të reja. Do të dini ta vlerësoni plotësisht personin që ju rri përkrah dhe t'ia kushtoni vëmendjen e duhur.</p>	 <p>AKREPI Është e kotë të prisni ndryshime në punë. Jeni ju që duhet të bëni diçka për t'u ngritur në detyrë. Nuk mund t'ia lëni më rastësisë.</p>	 <p>SHIGJETARI Të jeni më të dashur nuk ju bën veçse mirë. Padyshim se do t'i lehtësonte ndjeshëm raportet me personin që keni në krah.</p>	 <p>BRICJAPI Duke u marrë me çështje të zezës mund t'ju bëjnë që të lini pas dore punën. Por duhet të keni përqendrim dhe qartësi në mendime.</p>	 <p>UJORI Loja e dashurisë do t'ju shtyjë të gënjejnisi disa, duke shpikur ëndrra dhe iluzione, por do t'ju shërbejë për të pasur një takim edhe më të mirë.</p>	 <p>PESHQIT Do t'ia dilni të gjeni edhe aleatë. Nëse do të ketë fërkime brenda familjes, largojuni duke e kaluar me sportivitet.</p>

Vanessa fajëson kompaninë e helikopterëve për vdekjen e Kobe Bryantit dhe vajzës së tyre Gianna



Mësohet se Vanessa Bryant do të nxjerrë në gjyq kompaninë e helikopterëve dhe kërkon dëmshpërblim miliona dollarë për vdekjen e legjendës së basketbollit, Kobe dhe vajzës së tyre 13-vjeçare, Gianna. Bashkëshortja e basketbollistit të ndjerë fajëson pilotin Ara Zobayan i

cili ndërroi jetë gjatë aksidentit, pasi ai nuk mori të dhënat e motit para se ta niste helikopterin. Sipas Vanessës, ai duhet të kishte anuluar fluturimin kur pa situatën e vështirë. Tashmë ajo kërkon dëmshpërblim ekonomik dhe nuk do të heqë dorë derisa drejtësia të vendoset në vend.

Lopezi dhe Rodriguezi shfaqen me veshje sportive



Jennifer Lopez dhe i fejuari Alex Rodriguez janë fotografuar tekta dilnin nga shtëpia për të shkuar në plazh në Malibu. "Daily Mail" shkruan se supervila që çifti i njohur shkoi për të vizituar nga afër kush-ton 70 mijë dollarë në muaj. Lope dhe Rodriguez po kërkojnë të marrin me qira një shtëpi verore pasi kaluan

karantinën në Miami gjatë pandemisë koronavirus. Nga fotot e publikuara nga mediat e huaja, duket se 50-vjeçarja dhe 44-vjeçari janë kombinuar shumë bukur me njëri-tjetrin. Që të dy shfaqen me veshje sportive të zeza, ndërkohë e kanë thyer këtë ngjyrë me nga një palë atlete të bardha.



Kylie Jenner, e mrekullueshme me vajzën në foton e fundit në "Instagram"

Kylie Jenner dhe vajza e saj Stormi kanë pozuar krah njëra-tjetrës në një fotografi në "Instagram" të ndarë nga ylli i njohur televiziv. 22-vjeçarja dhe vajza e saj dyvjeçare u shfaqen në veshje "blu" në foton e fundit në rrjetin social. Kylie që ndiqet nga afro 181 milionë ndjekës në


"Instagram" shkroi: "U zgjuam në perëndimin e egër". Ylli i Keeping Up With The Kardashians dukej e mrekullueshme dhe me stil. Kylie, gjithashtu, ndau një videoklip të shkurtër në "Instagram" teksa pozoi duke treguar stilin e ri të flokëve që menjëherë u bë trend nëpër botë.

Kimi ka një rival të fortë, Kanye West do ta lansojë linjën e produkteve të bukurisë



Kanye West është duke nisur një linjë të produkteve të bukurisë dhe kozmetikës. Padyshim se është frymëzuar nga gruaja e tij, Kim Kardashian dhe motra e saj Kylie Jenner, të cilat kanë qenë jashtëzakonisht të suksesshme me linjën e tyre të produk-

teve të bukurisë. Reperi amerikan bashkëpunoi me "Adidas" për ta krijuar linjën e modës "Yeezy". Tani besohet se kompania Kanye ka bërë kërkesë për një markë tregtare "Yeezy" për t'i mbuluar produktet e bukurisë dhe të kujdesit për lëkurën.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Sot përcaktohen finalistët e Kupës

Sot zhvillohen dy ndeshjet kthyesë në kuadër të gjysmëfinalës së Digitalb Kupës së Kosovës në futboll. Vëmendja e të gjithë sportdashësve është në Drenas, ku takohen Feronikeli dhe Ballkani, të cilat synojnë kualifikimin në finale. Në ndeshjen tjetër Prishtina e ka më lehtë përballë Drenicës, pasi ndeshjen e parë e ka fituar me rezultat 3-0



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Skuadra e Ballkanit nga Suhareka, edhe përkundër rezultatit jo të mirë në ndeshjen e parë gjysmëfinale të Digitalb Kupës së Kosovës në futboll kundër Feronikelit (0-0), synim e ka kualifikimin në finale.

Klubi i Ballkanit ka marrë vendim që asnjë futbollist të mos ketë të drejtën e deklarimit për media para ndeshjes kthyesë në kuadër të Kupës me arsyetimin që ata të fokusohen maksimalisht vetëm në ndeshje.

Redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re" e ka kontaktuar drejtorin e klubit, Avni Bytyçi, i cili ka thënë se Feronikeli ka një skuadër të mirë, por Ballkani në Drenas shkon për fitore. "Skuadra e Feronikelit është shumë cilësore dhe jo rastësisht është kampion në fuqi dhe fitues i Kupës,

prandaj ne kemi respekt për këtë klub. Rezultati 0-0 nga ndeshja e parë ka qenë real dhe tash jemi përgatitur për ndeshjen kthyesë, ku pa asnjë presion shkojmë për fitore. Atmosfera në klubin tonë është e mirë dhe jemi të gatshëm për fitore, kurse mungesa e vetme për këtë ndeshje është ajo e kapitenit Visar Berisha", ka thënë Bytyçi.

Ballkani edhe dy ndeshjet e tjera në kampionat kundër Drenicës dhe Flamurtarit nuk arriti t'i fitojë, pasi të dyja ndeshjet përfunduan me rezultat 0-0. Në anën tjetër, Feronikeli ka treguar formë më të mirë në tri ndeshjet e fundit ku, përveç barazimit me Ballkanin, i ka mposhtur Vushtrinë dhe Dukagjinin e Klinës. Për ndeshjen që zhvillohet sot (e mërkurë) ka folur për gazetë mesfushori Besmir Bojku. Edhe përkundër asaj që "Nikli" e ka synim kryesor Kupën në këtë edicion, Bojku

është treguar mjaft i matur në deklaratën e tij. "Për Ballkanin nuk duhet harxhuar shumë fjalë pasi e ka një ekip shumë të mirë dhe pa dyshim se është ndër skuadrat më të mira në vend. Ne do të përpiqemi që ta arrijmë objektivin që kemi", ka thënë Bojku.

Në gjysmëfinalen tjetër që zhvillohet në Skenderaj do të përballen Drenica dhe Prishtina. Ndeshjen e parë të zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" e kishte fituar skuadra kryeqytetase me rezultat 3-0, prandaj kualifikimi në finale duket një mision i lehtë për Prishtinën. Pas humbjes në ndeshjen e parë, Drenica duket se është dorëzuar përfundimisht në garën e Kupës dhe të gjithë fokusin e ka rikthyer në kampionat për ta siguruar mbijetesën në rangun më të lartë të futbollit në Kosovë. Të dyja ndeshjet zhvillohen me fillim nga ora 16:30, kurse finalja e madhe e Kupës do të zhvillohet më 29 korrik.

SHKURT

Besa në bisedime me Sokolin

Besa e Pejës e ka siguruar rikthimin në Superligë pasi ishte e para në renditjen tabelore kur Federata e Futbollit e Kosovës mori vendim për përfundimin e Ligës së Parë. Skuadra pejane po mendon të paraqitet sa më seriozisht në elitë dhe për këtë ka kontaktuar disa trajnerë, por synim kryesor është Bylbyl Sokoli. Ky i fundit vazhdon të jetë trajner i lirë, derisa në të kaluarën me sukses ka drejtuar shumë skuadra në futbollin e Kosovës. Skuadrën e Besës në edicionin e fundit e ka drejtuar Miftar Rama.

Reja: Napoli bëri mirë që e bleu Rrahmanin

Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Edy Reja, e ka cilësuar blerje të madhe për Napolin transferimin e Amir Rrahmanit. 73-vjeçari, duke folur për radio "Kiss Kiss", nuk i ka kursyer lëvdatat për Amir Rrahmanin, i cili, sapo të mbyllet sezoni, do të jetë nën urdhrat e Gattusos te Napoli. "Rrahmani është një futbollist shumë i mirë. Napoli bëri mirë që e bleu. Ka marrë një nga mbrojtësit më të mirë që luajnë në Itali, edhe sepse luan në mbrojtjen me tre", ka thënë Reja.

FBK-ja, fituese e projektit për zhvillim të gjeneratave të reja

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) për vitin e gjashtë radhazi është fituese e projektit të FIBA Europe për zhvillim të gjeneratave të reja të ashtuquajtur FIBA Europe Youth Development Fund. FIBA Europe së fundi e ka informuar FBK-në se e ka aprovuar aplikacionin e dorëzuar javë më parë nga FBK-ja në FIBA Europe. FBK-ja do ta vazhdojë projektin e përbashkët edhe në dy vjetet e ardhshëm (2020-2022) me katër federatat e tjera nacionale: të Turqisë, Bullgarisë, Rumanisë dhe Maqedonisë së Veriut, kurse Federata Turke e Basketbollit do të vazhdojë të jetë udhëheqëse e këtij projekti. Në këtë projekt do të jenë të përfshirë djem e vajza të moshës 13 vjeç dhe trajnerë të rinj e të talentuar. Projekti do të fillojë të zbatohet që nga muaji korrik me takimin e parë të menaxherëve të projektit dhe më pas do të vazhdojë me aktivitetet e tjera si Kampe Nacionale, turne ndërkombëtarë në shtetet pjesëmarrëse të projektit për djem e vajza dhe klinika të trajnerëve në Turqi.

Kosova në grup me Suedinë, Malin e Zi dhe Rumaninë

Prishtinë, 16 qershor - Përfaqësuesja e Kosovës në Hendboll (meshkujt) do të luajë në një grup të vështirë në kualifikimet për "Euro 2022".

Shorti për Evropianin e ardhshëm në hendboll është tërhequr të martën pasdite. Kosova ka rënë në grupin e tetë, që nga drejtues të FHK-së është

vlërësuar i vështirë. Kosova do të përballen me Suedinë, Malin e Zi dhe Rumaninë. Suedia ishte në vazon e parë, Mali i Zi në të dytën, kurse Rumania në

vazon e tretë. Kualifikimi në Evropian mundësohet me renditje në dy vendet e para në grup, por ka gjasë edhe prej pozitës së tretë.

MENS EHF EURO 2022 23 - 30 JANUARY HOLBRO, SUECIA			
GROUP 1	GROUP 2	GROUP 3	GROUP 4
FRANCE GERMANY SERBIA BELGIUM CROATIA	AUTRIA SLOVAKIA SLOVENIA ESTONIA	CZECH REPUBLIC RUSSIA UKRAINE FINLAND	ICELAND PORTUGAL LITHUANIA HUNGARY
GROUP 5	GROUP 6	GROUP 7	GROUP 8
SLOVENIA NETHERLANDS POLAND TURKEY	NORWAY LATVIA SWITZERLAND ITALY	DENMARK NORTH MACEDONIA ROMANIA FINLAND	SWEDEN PORTUGAL ROMANIA KOSOVO

Rritet numri i të prekurve me Covid-19 në NBA

FLORIDA, 16 QERSHOR - Rinisja e NBA-së nuk ka për të qenë aspak e lehtë. Lajmet e orëve të fundit nga qyteti që ndodhet në Florida nuk janë aspak të mira. Në "Orange County",

aty ku do të luhen ndeshjet e NBA-së, janë regjistruar 167 raste me "Covid-19" gjatë 24 orëve të fundit. Në total, në këtë zonë janë konfirmuar gjatë kësaj jave 186 raste me

koronavirus, ndërkohë që javën e kaluar ishin regjistruar vetëm 54 raste. Kjo ka krijuar jo pak panik te drejtuesit e NBA-së dhe skuadrat, që në mesin e korrikut do të shko-

jnë në Orlando për ta vijuar fazën përgatitore. NBA ka vendosur të kryejë teste çdo dy ditë, por frika sërisht është e madhe te klubet dhe lojtarët.



Zenelaj: Të luash për Kosovën është krenari e madhe

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Shumë basketbollistë të Kosovës luajnë me sukses në skuadrat evropiane. Një prej tyre është edhe Denis Zenelaj. Ai paraqitet për skuadrën gjermane Eisbaren Bremerhaven në Bundesliga 1 për U-19. "Sezoni i fundit ka qenë shumë i suksesshëm për mua si me paraqitje personale, ashtu edhe ekipore", ka thënë në fillim Zenelaj për faqen zyrtare të FBK-së. "Synimet e mia për të ardhmen janë të jem pjesë e Bundesligës së Parë gjermane dhe pjesë e një skuadre të Euroligës. Real Madridi, Fenerbahçe dhe CSKA Moska janë skuadrat e mia të preferuara ku do të doja të luaja një ditë", ka shtuar tutje Zenelaj.

Denisi, i cili ka luajtur për Kerasan Prishtinën, është pjesë e grupmoshave të reja të Kosovës. "Të luash për Kosovën është një ndjenjë krenarie dhe



kënaqësi që mund ta ndiej vetëm kur luaj për Kosovën dhe jo në ndeshje të tjera", ka shtuar tutje basketbollisti i talentuar. Në fund tregon se sa e rëndësishme është të stërvitesh në këtë kohë pandemie. "Është shumë e rëndësishme që të

jemi fizikisht në formë sepse në kohët e vështira dallojnë lojtarët e pasuksesshëm nga ata të suksesshëm", përfundoi Denis Zenelaj. Ai është vetëm 17-vjeçar dhe shihet si një basketbollist me të ardhme të ndritur.

Todt: Ja pse Alonso dhe Vetteli kanë dështuar me Ferrarin

MARANELLO, 16 QERSHOR - Prej 13 vjetësh skuadra e Ferrarit nuk arrin të triumfojë me pilotët e saj në Formula 1 edhe pse e kanë pilotuar kampionë bote. Fillimisht Red Bull dhe më pas Mercedesi kanë arritur t'i mposhtin pilotët e "kokëkuqes". Gjatë dhjetë vjetëve të fundit në makinën nga Maranello kanë qenë dy kampionë absolutë si Fernando Alonso e Sebastian Vettel. Gjithsesi, të dy kanë dështuar të shpallen kampionë me makinën italiane.

Jean Todt, njeriu që drejtoi Ferrarin në periudhën e artë me Michael Schumacherin, bën një analizë. "Ky është një sport ku kombinohen mes tyre piloti, makina dhe skuadra. Nëse këta tre komponentë ecin së bashku në të njëjtin drejtim, atëherë



piloti mund ta synojë titullin", ka thënë Todt. "Fakt është se Alonso e Vetteli nuk kanë pasur një makinë Ferrari të fortë. Mund të jesh i talentuar, por nëse nuk ke një mjet të shpejtë e

të besueshëm, nuk mund të garosh për fitore. Mos harroni, edhe Schumacherit iu desh kohë të shpallej kampion me Ferrarin", ka deklaruar Jean Todt.

Sarri: Nuk më intereson kundërshtari, dua të fitoj tituj

Trajneri i Juventusit, Maurizio Sarri, ka folur në prag të finales së Kupës së Italisë, që është planifikuar për t'u luajtur sonte (e mërkurë) në mbrëmje dhe që për rastësi do të gjejë përballë

të shkuarën e tij, Napolin. "Kur më thonë se nuk ke fituar asgjë në Itali, më vijnë k... rrotull. Kam ngjitur 8 skuadra një kategori më lart, por e di që janë shumë pak për ata që flasin për

tituj si Liga e Kampionëve e kampionatet e ndryshme. Nuk më intereson kundërshtari që kam përballë, por vetëm skuadra ime, pasi dua që ta fitojmë trofeun", ka deklaruar Sarri.

